



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 498 Akti

Nr. 619 Vendimi
Tiranë, më 3.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 1.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Altin Shkurti**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Willem Brouwer.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:
 - *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2018.

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar, duke konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Altin Shkurti*.
7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 23.12.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Altin Shkurti dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Për një proces të rregullt ligjor, z. Altin Shkurti i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës dhe për të dhënë shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Z. Altin Shkurti, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 23.1.2023. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit kundërshtoi gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 26.1.2023.

²Me shkresën nr. *** është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. ***, datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2022.

13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 1.2.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer.
14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Altin Shkurti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
 - d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
 - f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
 - g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
22. Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Altin Shkurti, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti është bërë subjekt deklarues në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2003 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).
24. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

Pasuritë e subjektit të rivlerësimit

25. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasuritë:

26. Apartament në Tiranë

Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar një apartament me sip. 109 m², 2+1, nr. **, me adresë rruga “Z.J”, pallati “B”, Tiranë, blerë në shumën 65.000 euro. Si burim krijimi në momentin e blerjes subjekti ka deklaruar: hua shumën 4.800.000 lekë, me kontratën nr. ***, datë 4.6.2008; dhuratë shumën 3.000 euro nga babai i bashkëshortes P.L; si dhe kursimet e realizuara nga të ardhurat e akumuluar nga puna dhe angazhime të tjera ndër vite.

Në DPV⁴/2007 ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes për blerjen e apartamentit në shumën 65.000 euro, nga e cila është paguar vlera 23.000 euro, pa specifikuar burimin e shumës së paguar dhe mënyrën e fitimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 20.7.2007.

Hetimi i Komisionit

27. ASHK-ja⁵ ka informuar se z. Altin Shkurti dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë të kenë pasuri të regjistruar në pronësi të tyre.

27.1 FSHU-ja⁶ ka informuar se në emër të z. Altin Shkurti rezulton një abonent me kontratë furnizimi në kategorinë familjare në rrugën “Z.J”, Tiranë.

27.2 Shoqëria “B”⁷ sh.p.k. ka informuar se shtetasi Altin Shkurti ka porositur një apartament sipas kontratës me nr. ***, datë 20.7.2007, në shumën 65.400 euro, shumë e likuiduar e plotë nga ky shtetas, por nuk disponohet dokumentacion pagesash.

27.3 Dorëzimi i apartamentit është kryer në vitin 2009, pa dokument shkresor. Shtetasi në fjalë nuk është paraqitur për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë, pavarësisht njoftimit të kryer nga shoqëria.

27.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸ ka depozituar listën e proceseve gjyqësore të zhvilluara në këtë gjykatë, ku shoqëria “B” sh.p.k. dhe përfaqësuesit e saj ligjorë kanë qenë palë ndërgjyqëse. Nga hetimi i kryer nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë shoqërinë “B” sh.p.k. apo përfaqësuesit e saj ligjorë.

27.5 ISSH-ja⁹ ka referuar të dhëna për të ardhura të përfituara nga punësimi i rregullt për shtetasit Altin dhe D.Shkurti nga janari i vitit 2012 e në vijim.

Analiza e fakteve

28. Nga aktet e dosjes rezulton se subjekti ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje me nr. ***, datë 20.7.2007, me shoqërinë sipërmarrëse “B” sh.p.k., përfaqësuar nga z. M. S, sipas së cilës subjekti ka porositur një apartament me sip. 109 m², 2+1, në vlerë totale 65.400 euro. Palët kanë dakordësuar që pagesa të kryhet me tri këste:

- kësti i parë 25.000 euro brenda muajit dhjetor 2007;
- kësti dytë 25.000 euro në fund të muajit mars 2008;
- shumata e mbetur do të paguhet nga porositësi me mbarimin e punimeve dhe marrjen e çelësave në dorë.

28.1 I pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar¹⁰ se pagesat për shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit nuk janë kryer sipas kësteve të parashikuara në kontratë, por

⁴Këtu e në vijim “DPV”i referohet Deklarimit Periodik Vjetor.

⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2021, nr. *** prot., datë 15.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 30.4.2021.

⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2022.

⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2022.

⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022.

¹⁰Në përgjigjet e pyetësorit nr. *, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022.

mbi bazën e avancimit të punimeve sipas mandatpagesave të depozituara¹¹ nga subjekti.

28.2 Subjekti ka shpjeguar se detyrimi ndaj shoqërisë ndërtuese është përmbushur plotësisht. Ndërtuesi nuk ka pretenduar asnjëherë për pagesa të kryera me vonesë prej tij, sepse ato janë kryer duke pasur parasysh edhe avancimin e punimeve.

28.3 Në lidhje me mosregjistrimin e këtij apartamenti në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, subjekti ka shpjeguar se: *“Kjo pasuri është ende e paregjistruar në ASHK. Me sa më kujtohet ndërtuesi ka ndërtuar jashtë lejes së ndërtimit, gjë që ka penguar fillimisht kalimin e pasurisë në pronësi. Në vijim, komshinjtë më kanë thënë që ndërtuesi ka kërkuar që porositësit të paguajnë pagesat për veprimet noteriale dhe taksat për kalimin e pronësisë, gjë që vjen në kundërshtim me kushtet kontraktore, ku një gjë e tillë është marrë përsipër nga sipërmarrësi. Në këto kushte nuk jam takuar me sipërmarrësin për të biseduar për kalimin e apartamentit në pronësi, sepse nuk mund të kryej pagesa që në bazë të kushteve të përcaktuara kontraktore, duhet të kryhen nga sipërmarrësi”*.

Analiza mbi burimet e krijimit

29. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin:

- kursimet e realizuara nga të ardhurat e akumuluar nga puna dhe angazhime të tjera në vite;
- hua në shumën 4.800.000 lekë;
- dhuratë në shumën 3.000 euro nga babai i të fejuarës.

29.1 Në DPV/2007, në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar se ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin e një apartamenti 2+1, në shumën 65.400 euro, nga e cila është paguar vlera 23.000 euro, me burim:

- kursimet në vite të deklaruara më parë;
- vlera 3.000 euro hua marrë nga babai i të fejuarës.

29.2 Në DPV/2008, subjekti ka deklaruar se ka shlyer shumën 9.000 euro për apartamentin, nga e cila vlera 4.000 euro është nga huaja e marrë sipas kontratës së huas nr. ***, datë 4.6.2008. Në këtë DPV subjekti nuk ka deklaruar në fund të vitit likuiditetin *cash*, të mbetur nga huaja. Kjo pasaktësi në plotësimin e deklaratës është korrigjuar prej tij në DPV/2009, ku ka deklaruar qartë burimin për pagesën e kryer në shumën 30.000 euro, me vlerat e mbetura nga huaja e marrë një vit përpara tek z. H. H.

¹¹Mandatarkëtimet e depozituar nga subjekti: nr. *, datë 30.12.2007, paguar shuma 23.000 euro; nr. *, datë 18.6.2008, paguar shuma 5.000 euro; nr. *, datë 31.12.2008, paguar shuma 4.000 euro; nr. *, datë 8.4.2009, paguar shuma 8.000 euro; nr. **, datë 2.7.2009, paguar shuma 10.000 euro; nr. **, datë 17.11.2009, paguar shuma 10.000 euro; nr. **, datë 20.12.2009, paguar shuma 2.000 euro; nr. **, datë 25.12.2009, ku përshkruhet se: *“Është njohur dhe zbritur nga çmimi i shitjes shuma prej 3.400 (tre mijë e katërqind) euro për punimet e kryera në banesë nga vetë unë”*.

29.3 Në lidhje me shumën 3.000 euro, që subjekti e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si dhurim dhe në DPV/2007 e ka deklaruar si hua, subjekti ka shpjeguar¹² se: “Në vitin 2007 unë i kam marr borxh babait të të fejuarës sime, aktualisht bashkëshorte dhe nëna e fëmijëve të mi. Në vijim kur kam biseduar për t’ia kthyer ai më ka thënë që nuk është e nevojshme t’ia kthej sepse ma ka dhuruar, si një kontribut të vogël që ai i ka dhënë për banesën ku do jetojë vajza e tij me fëmijët e saj. Me zakon më takon mua si babai i vajzës që ta paguaj dhomën e gjumit të çiftit. Për këtë shkak ajo shumë është deklaruar fillimisht si borxh dhe në vijim si dhuratë”.

29.4 Në lidhje me këtë mospërputhje deklarimesh, Komisioni arsyeton se personi tjetër i lidhur me subjektin, në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, në raport me detyrimin ligjor, si huadhënësi dhe dhuruesi mbartin të njëjtën peshë, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Hetimi i Komisionit mbi burimet e krijimit

30. Sipas deklaramit të subjektit, për blerjen e apartamentit janë përdorur burimet si vijojnë:

- a) kursimet e subjektit të rivlerësimit;
- b) shuma 3.000 euro dhuratë nga prindërit e bashkëshortes;
- c) shuma 4.800.000 lekë hua marrë z. H.H.

a. Lidhur me kursimet e subjektit të rivlerësimit

30.1 Subjekti, në deklaratën *Vetting* dhe në DPV/2007, kur u krye pagesa, shumën prej 23.000 euro nuk e ka deklaruar sa ishin kursimet e tij, por referuar deklarimeve në DPV dhe akteve të administruara rezulton se brenda datës 30.12.2007 ka paguar këstin e parë për blerjen e apartamentit në shumën 23.000 euro, nga e cila 20.000 euro janë kursimet e subjektit.

30.2 Në lidhje me kursimet ndër vite, i pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se¹³: “Kursimet i takojnë periudhës nga 1997 – 2007, ku janë përfshirë edhe gjendjet cash të akumuluar në vite sipas deklarimeve të tij në DPV. Në total deri në vitin 2007, kur është paguar shuma prej 23.000 euro për pagimin e shtëpisë në bazë të kontratës, është kursyer shuma 2.800.000 lekë. Në këtë shumë është përfshirë edhe shuma 3.000 euro, dhënë nga vjehri i subjektit, z. P. L.

Në vitin 2002 kam pasur shumën e kursyer të të hollave prej 1.100.000 lekësh. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën drejtuar Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në vitin 2003. Këto kursime janë realizuar nga të ardhurat e mia të përfituara nga Shkolla si dhe të ardhurat e tjera nga puna si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë nga 1 tetori 1999 deri në dhjetor 2002 dhe trajnime e vizita studimore jashtë Shqipërisë.

Vlen të theksohet se – deklaron subjekti:

¹²Me email-in datë 21.9.2022, si dhe provat e ardhura me postë.

¹³Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 21.9.2022, si dhe provat e ardhura me postë me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022.

i) Në periudhën 22 qershor – 1 korrik 1999 kam qenë në vizitë studimore në E.C of H R(S, France), the T de G I of C (France), the J.B.W (S,Germany) and the G s der D der J des K Z (Z, Switzerland), ku na është dhënë një kompensim jetik prej 150 FF për qëndrimin në Strasbourg (përveç kësaj Këshilli i Evropës ka mbajtur shpenzimet për ushqim dhe akomodim) dhe 999 FF për ditët e qëndrimit jashtë Strasbourgut.

ii) Në periudhën (26 shkurt – 4 maj 2001) kam marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga ***, ku nga njëri prej followship donors të *** (që nuk më është bërë i njohur) më është paguar tuition fee (12,500 US Dollar) dhe për diem (7.400.000 Italian Lira).

iii) Në periudhën (25 shtator – 20 tetor 2000) kam marrë pjesë në kursin Law and Justice as Tools for D at C. B. School, C for C. E, në C.Danimark.

iv) Gjatë vitit 2003 kam kursyer shumën 300.000 lekë. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën përkatëse të deklarimit, drejtuar ILDKPKI-së.

v) Në vitin 2004 është kursyer shuma 350.000 lekë. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën përkatëse të deklarimit, drejtuar ILDKPKI-së.

vi) Në vitin 2005 është kursyer shuma 350.000 lekë. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën përkatëse të deklarimit, drejtuar ILDKPKI-së.

vii) Në vitin 2006 është kursyer shuma 400.000 lekë. Pjesërisht të depozituar në banesë dhe pjesërisht në 'Raiffesen Bank'. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën përkatëse të deklarimit, drejtuar ILDKPKI-së.

viii) Në vitin 2007 është kursyer shuma 300.000 lekë.

ix) Në total deri në vitin 2007, kur është paguar shuma prej 23.000 euro për pagimin e shtëpisë në bazë të kontratës, është kursyer shuma 2.800.00 lekë (e konvertuar). Në këtë shumë është përfshirë edhe shuma 3.000 euro, marrë vjehrrit tim P.L.

x) Në vitin 2008 është marrë hua shuma prej 4.800.000 lekësh me kontratën e huas nr. ***, datë 4.6.2008. Në këtë vit janë paguar për shlyerjen e kontratës së sipërmarrjes shuma 9.000 euro (5.000 euro nga shuma e marrë hua dhe 4.000 euro nga kursimet e këtij viti).

xi) Në vitin 2009 është paguar shuma 30.000 euro. Burim është shuma e mbetur e marrë hua prej 4.800.000 lekë.

xii) Në vitin 2009 është kursyer gjithashtu shuma 3.400 euro nga paga dhe shpërblimet e këtij viti, e cila është paguar për punime të kryera nga unë, të cilat janë zbritur nga ndërtuesi në çmimin e përgjithshëm të shitjes”.

30.3 Në vijim, Komisioni ka analizuar deklaratimet e subjektit në vite, nga ku rezulton se në DPV-në e parë në vitin 2003 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.100.000 lekë, krijuar me të ardhurat nga firmat piramidale dhe kursime nga paga e puna. Komisioni analizoi mundësinë e subjektit për të disponuar deri në vitin 2003 shumën 1.100.000 lekë.

a/1. Mundësia e subjektit për të disponuar kursime *cash* në shumën 1.100.000 lekë, në vitin 2003

30.4 Komisioni analizoi mundësitë e subjektit për kursim në shumën 1.100.000 lekë, sipas DPV/2003, duke i kërkuar subjektit të dokumentojë të ardhurat që kanë shërbyer si burim për këto kursime.

30.5 Subjekti ka shpjeguar¹⁴ se: “*Shuma e kursyer prej 1.100.000 lekësh, deklaruar në deklaratën e parë të pasurisë është një shumë e akumuluar ndër vite, duke filluar që nga koha e përfundimit të studimeve. Gjatë periudhës së studimeve kam përfituar bursë në vitin e katërt (bursa konsistente në pagesën e një shume që me sa më kujtohet ishte në 6.000 lekë/muaj. Menjëherë pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, kam filluar punë si asistent/avokat e më pas avokat pranë avokates prof. K.B. Po kështu, që në datën 10.10.1996, datë në të cilin ka dalë në qarkullim revista juridike ‘T. J’”.*

30.6 Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën e parë të pasurisë, tek burimi i kursimeve nga paga/puna, janë përfshirë të ardhurat e krijuara ndër vite prej tij, si vijon:

- a. *Të ardhura nga bursa e studimit për vitin akademik 1994 – 1995, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës është paguar afërsisht shuma 54.000 lekë.*
- b. *Viti 1997 nga Shkolla e Magjistraturës, paguar shuma 31.788 lekë.*
- c. *Viti 1998 nga Shkolla e Magjistraturës, paguar shuma 164.860 lekë.*
- d. *Viti 1999 nga Shkolla e Magjistraturës, paguar shuma 163.860 lekë.*
- e. *Viti 1999 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paguar shuma 102.390 lekë.*
- f. *Viti 2000 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paguar shuma 434.170 lekë.*
- g. *Viti 2001 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paguar shuma 468.168 lekë.*
- h. *Viti 2001 nga botimi i Komentarit të Kodit Penal Ushtarak, përfituar shuma 223.950 lekë.*
- i. *Viti 2002 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paguar shuma 506.514 lekë.*
- j. *Të ardhura të realizuara nga:*
 - *vizita studimore në E.C of H.R (S, France), the T de G.I of C (France), the J.B W(S, Germany) and the G.s der D der J des K.Z(Z, Sëitëzland), në periudhën 22 qershor – 1.7.1999 kam sjellë shumën 1.350 FF (5 ditë qëndrimi në Strasbourg 150 FF/dita + 2 ditë në Shtutgard dhe 2 ditë në Zvicër 4 ditë nga 150 FF/dita);*
 - *trajnimi në Danimarkë në periudhën (25 shtator – 20.10.2000) më është paguar paga nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me sa më kujtohet kam sjellë në Shqipëri shumën 800 USD;*
 - *trajnimi në Romë për periudhën (26 shkurt – 4.5.2001) më është paguar paga nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me sa më kujtohet kam sjellë në Shqipëri shumën 1.000.000 lireta.*

¹⁴Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me email-in e datës 23.11.2022.

k. Nga kopja e mandatpagesave që prindërit kanë ruajtur dhe më dhanë rezulton se kam depozituar personalisht në firmën piramidale “P”, me mandatpagesën nr. ***, datë 7.10.1996, shumën 100.000 lekë. Nga kjo shumë, nga Banka Kombëtare Tregtare, referuar legjislacionit të shpërndarjes së fondeve të fondacionit “P” (ku është shpërndarë 52 % e shumës së depozituar) rezulton se unë kam përfituar shumën 52.000 lekë (shuma e sipërcituar vërtetohet me mandatpagesën nr. ***, datë 7.10.1996, që po e depozitoj me cilësinë e provës).

30.7 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve për kursimet e tij në vite, ka depozituar¹⁵ aktet provuese, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioni dhe janë reflektuar në analizën financiare.

Analiza financiare

30.8 Komisioni kreu analizën financiare deri në fund të vitit 2003, duke përfshirë të ardhurat e ligjshme ndër vite, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe në të dhënat e rezultuara nga hetimi.

30.9 Referuar të dhënave nga Zyra e Gjendjes Civile, ka rezultuar se subjekti është ndarë nga trangu familjar në datën 29.7.2003, për rrjedhojë janë marrë në konsideratë deri në këtë datë të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së përbërë nga dy prindërit dhe vëllai, më saktësisht që nga viti 1994 deri në vitin 2003.

30.10 Në lidhje me të ardhurat e pretenduara të siguruara nga interesat e firmave piramidale, nga dokumentacioni u evidentuan vetëm mandatarkëtimet e shumave të investuara nga subjekti, të cilat nuk janë në formën e kërkuar nga ligji. Gjithashtu, nuk u provuan shumat e fituara nga interesat dhe as tërheqja e këtyre shumave nga firmat piramidale. Për këtë arsye, Komisioni ka vlerësuar të mos reflektojë këto të ardhura të përfituara nga interesat (rreth shumës 52.000 lekë) në analizën financiare.

30.11 Në lidhje me të ardhurat nga vizita studimore dhe trajnimeve të pretenduara, Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e përfituara gjatë një vizite studimore në European Court of Human Rights, në periudhën qershor – korrik 1999 ku, sipas dokumentacionit, pjesëmarrësit, në vizitën studimore, përveçse kishin shpenzimet e qëndrimit dhe ushqimit të mbuluara nga organizatorët, kishin gjithashtu dietë ditore, si dhe një shumë shtesë për ditët e qëndrimit.

¹⁵Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 21.9.2022, si dhe provat e ardhura me postë me shkresat nr. *** prot., datë 21.9.2022, nr. *** prot., datë 26.9.2022, nr. *** prot., datë 18.11.2022, si dhe me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2022, janë depozituar aktet: vërtetim për pagën *bruto* dhe *neto* për periudhën janar 2000 – gusht 2022; vërtetim për pagën *bruto* dhe *neto*, 5 fletë; praktikë pjesëmarrjeje në seminarin “Development Lawyers Course”, 4 fletë; ftesë pjesëmarrjeje në seminarin Copenhagen 25 shtator – 20 tetor 2000, 1 fletë; ftesë pjesëmarrjeje në seminar në Strasbourg 22.6 – 1.7.1999, 3 (tri) fletë; kontratë shërbimi lidhur me U.E të Tiranës, 9 fletë; kontratë pune me ***-në datë 23.11.2016, 1 fletë; vërtetim *** prot., datë 24.1.2022, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit vërtetohet se z. A.Sh ushtron detyrën e gjyqtarit nga data 27.9.2000 dhe aktualisht. Për periudhën 1.10.1999 – 27.9.2000 ka kryer stazhin profesional/gjyqtar po pranë kësaj Gjykate; *email* drejtuar Shkollës së Magjistraturës datë 15.9.2022, ku subjekti kërkon të dokumentohet për pagesat e përfituara gjatë Shkollës së Magjistraturës; vërtetim nr. *** prot., datë 7.10.2022, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim lëshuar nga F.Sh.F nr. *** prot., datë 3.20.2022, për të ardhurat e përfituara nga subjekti për periudhën 2014 – 2022; vërtetim nga universiteti “A.M”, Durrës, datë 26.9.2022, sipas të cilit vërtetohen të ardhurat e përfituara nga z. Altin Shkurti, për vitin akademik 2016 - 2017; pasqyrë të ardhurash nga universiteti “A.M”, Durrës; aktmarrëveshje shtator 2001, lidhur me shtëpinë botuese “A”, 4 fletë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.11.2022, e z. A.H, 3 fletë; Komentari i Kodit Penal Ushtarak të Republikës s Shqipërisë 3 fletë; Drejtësia 1/1996 2 fletë; Drejtësia 3-4/1996 2 fletë; T juridike 1/1996 3 fletë; T juridike nr. 3/1996, 3 fletë; mandatpagesa nga firmat piramidale, 3 fletë.

30.12 Bazuar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni ka përlllogaritur si të ardhur shtesë shumën 29.344 lekë, shumë kjo e konvertuar me kursin për muajin qershor të vitit 1999 të frangës franceze¹⁶.

30.13 Shpenzimet e jetesës për periudhën 1997 – 1999 janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave, ndërsa për periudhën 2000 – 2003 sipas standardit të ILDKPKI-së.

30.14 Në lidhje me kursimet¹⁷ në shumën 1.100.000 lekë, në vitin 2003, nga analiza e Komisionit subjekti ka rezultuar me një balancë negative në shumën 580.744 lekë. (referuar tabelës në raportin e hetimit).

a/2. Mundësia e subjektit për të kursyer shumën 20.000 euro në vitin 2007

30.15 Referuar deklarimeve të subjektit në vite, duket se shumat e akumuluarra deri në dhjetor të vitit 2006 është në vlerën 1.636.968 lekë. Kjo shumë e konvertuar në euro me kursin në vitin 2007, kur është kryer pagesa e këstit të parë, do të rezultonte në shumën 13.539 euro. Komisioni evidentoi se subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 1.420 euro gjatë vitit 2006.

30.16 Në lidhje me kursimet e depozituara në llogaritë bankare u evidentuan pakësime në llogarinë rrjedhëse të subjektit, ku kishte deklaruar kursime të depozituara në vitet 2005 dhe 2006, si dhe gjatë vitit 2007, duke i marrë në konsideratë edhe këto kursime si burim për pagesën e kryer në datën 30.12.2007.

30.17 Për blerjen e apartamentit subjekti, në datën 30.12.2007, ka paguar tek shoqëria “B” sh.p.k. shumën 23.000 euro, si këst i parë për blerjen e apartamentit. Në këtë shumë është përfshirë edhe dhurata prej 3.000 euro, e dhënë prej vjehrrit të tij. Në vijim, do të pasqyrohet analiza financiare për kursimet deri në vitin 2007, ku është trajtuar si një pagesë e vetme.

b. Mundësia e vjehrrit për dhurimin e shumës 3.000 euro në vitin 2007

30.18 Komisioni, në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar mundësitë financiare për dhënien e shumës 3.000 euro, dhuratë nga prindërit e bashkëshortes. Duke qenë se në vitin 2007 subjekti ka paguar si këst të parë për blerjen e apartamentit shumën 23.000 euro, ku është përfshirë edhe dhurata e vjehrrit prej 3.000 euro, Komisioni i analizoi bashkë këto dy burime, si pjesë të pagesës për këstin e parë, për blerjen e apartamentit.

Hetimi i Komisionit për të ardhurat e ligjshme të huadhënësit

¹⁶Banka e Shqipërisë/kursi i këmbimit.

¹⁷Sipas deklarimeve në deklaratën e pare të interesave private, para fillimit të detyrës.

30.19 QKB-ja¹⁸ nuk ka depozituar të dhëna për personin fizik “L.A.L”. Në faqen e QKB-së rezulton se personi fizik me këto të dhëna dhe me NUIS K***J, nuk ka përditësuar të dhënat në QKB.

30.20 DPT-ja¹⁹ ka informuar se:

- Shtetasi P.T.L nuk rezulton të ketë apo të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij.

- Shtetasja L.A.L rezulton të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të saj (tregti me pakicë) si person fizik, me NUIS K***J dhe që nga data 31.5.2012 rezulton me status “pasiv”. Deklaratat e viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009 janë dorëzuar me 0 (zero) xhiro, rezulton pa aktivitet.

30.21 ISSH-ja²⁰ ka referuar të dhëna për të ardhura të përfituara nga:

- Shtetasi P.L nga punësimi i tij me të ardhura për periudhën janar 2012 – mars 2016 dhe në mars të vitit 2016 ka filluar të përfitojë pension pleqërie në shumën 23.584 lekë.

- Shtetasja L.L, nga punësimi i rregullt me të ardhura për periudhën shkurt 2012 – tetor 2015.

30.22 Nga qershori i vitit 2019 e në vijim ka përfituar pension pleqërie në shumën 18.427 lekë.

30.23 Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar akte provuese²¹, të cilat janë analizuar nga Komisioni. Referuar akteve, Komisioni kreu analizën financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet gjatë periudhës 1993 – 2007, për prindërit e bashkëshortes së subjektit.

30.24 Nga verifikimi i llogarive bankare u evidentua se prindërit e bashkëshortes së subjektit kishin marrë dhe paguar një kredi në shumën 500.000 lekë, e përlllogaritur edhe kjo në tabelën e analizës financiare mbi mundësitë për kursim.

30.25 Nga analiza financiare e kryer për shumën 3.000 euro rezultoi se dhuruesit kishin mungesë burimesh të ligjshme në vitin 2007. Për pasojë, në analizën financiare për pagesën e këstit prej 23.000 euro, në datën 30.12.2007, nuk është përfshirë si burim dhurata në shumën 3.000 euro.

Në përfundim, analiza financiare për pagesën e këstit në shumën 23.000 euro, në vitin 2007, rezultoi me një balancë negative në shumën 1.131.836 lekë.

c. Huaja në shumën 4.800.000 lekë, me huadhënës z. H.H

¹⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2021.

¹⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 21.4.2021.

²⁰Me shkresën nr. *** rep., datë 23.3.2022.

²¹Si vijon: shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2022, lëshuar nga ISSH – Dega e Arkivit, që i takojnë z. P.L dhe znj. L. L; shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2022, e ISSH-së; shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2022, e ISSH-së; shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2022, e ISSH-së; kthim përgjigjeje “Dega e Fondit Arkivor të Kontributeve” nr. *** prot., datë 26.09.2022, informacion për të ardhurat e shtetasve P dhe L.L; kthim përgjigjeje “Drejtoria Rajonale Tiranë (Dega e Arkivës)” nr. *** prot., datë 27.9.2022; kthim përgjigjeje “Dega e Arkivit Rajonal Tiranë” nr. *** prot., datë 29.9.2022; kthim përgjigjeje “Drejtoria Rajonale Tiranë (Dega e Informatikës)” nr. *** prot., datë 30.9.2022.

30.26 Subjekti për blerjen e apartamentit në Tiranë ka deklaruar si një prej burimeve huan në shumën 4.800.000 lekë, me huadhënës z. H.S.H, sipas kontratës së huas, për një periudhë kohe të pacaktuar dhe pa interes. Subjektit iu kërkua të dokumentojë mënyrën e marrjes së huas, për të cilën ka shpjeguar²² se: “Kjo shumë është marrë me kontratën e huas nr. ***, datë 4.6.2008 dhe, sikurse përcaktohet edhe në kontratë, është marrë cash²³”.

Hetimi i Komisionit mbi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit

30.27 Komisioni, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2916, ka shtrirë hetimin për huadhënësin dhe bashkëshorten e tij, si vijon:

30.28 QKB-ja²⁴ ka informuar se shtetasja Sh.H është regjistruar si person fizik në datën 30.6.2016, me NUIS L***R, me objekt “tregti me pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë”, aktualisht me status të “çregjistruar”.

30.29 DRT-ja Durrës²⁵ ka informuar se:

i) Shtetasja Sh.H.H është e regjistruar në DRT-në Durrës si tatimpagues “person fizik”, me NUIS K***S, me aktivitet “tregti ushqimor”, në lagjen “P”, P, Durrës me status “çregjistruar” nga data 18.5.2010. Personi fizik është regjistruar me vendimin nr. ***, datë 12.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga verifikimi në sistemin tatimor sipas deklarimeve të tatimpaguesit rezulton se ka deklaruar:

Viti	të ardhura
2005	1.000.000
2006	2.800.000

Gjithashtu, sipas të dhënave të sistemit tatimor, tatimpaguesi ka paguar për periudhën 2005 – 2008, shumën 209.538 lekë për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

ii) Tatimpaguesi “Sh.H”, person fizik, NIPT L***R, me aktivitet “tregti artikuj industrialë”, me adresë Lagjja nr. **, rruga “P”, Durrës dhe status “çregjistruar”, nga data 15.4.2019. Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS sipas situatës financiare të deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019, të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, të ardhurat e realizuara në këto vite.

iii) Tatimpaguesi “Sh.H”, ambulant, me NIPT L***I, me aktivitet “tregti ambulant”, me adresë “Lagjja nr. **, P, Durrës” rezulton me status “pasiv”, nga data 1.10.2014. Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS, sipas situatës financiare të deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014 dhe 2015, të ardhurat e realizuara paraqiten si vijon:

Viti	të ardhura
2014	nuk ka

²²Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 21.9.2022.

²³Shpjeguar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 23.11.2022.

²⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2022.

²⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2022.

2015 nuk ka

30.30 ISSH-ja²⁶ informon se shtetasi H.H është trajtuar me pension pleqërie nga periudha 1992 – qershor 2011, me masë mujore përfundimtare 26.800 lekë dhe ka përfituar pension suplementar ushtarak me masë mujore përfundimtare 10.968 lekë.

30.31 ISSH Dega Rajonale Durrës²⁷ ka informuar se znj. Sh.H.H është trajtuar me pension pleqërie me nr. *** prot., për periudhën 1.3.1999 – 10.7.2021, duke përfituar në total shumën 3.063.699 lekë.

30.32 Për periudhën 10.7.2021 – 30.9.2022 znj. Sh. H ka përfituar pension familjar me nr. ***, duke përfituar në total shumën 91.440 lekë, si dhe pension familjar suplementar me nr. PPP***, duke përfituar në total shumën 81.518 lekë.

30.33 Nga hetimi i Komisionit, referuar shkresës së ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁸, nuk rezultuan të dhëna lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi me huadhënësin.

30.34 Për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësit, subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës²⁹, i cili u analizua nga Komisioni.

Analiza financiare për huan me shumë 4.800.000 lekë

30.35 Komisioni kreu një analizë financiare mbi mundësinë e dhënies së huas në shumën 4.800.000 lekë, në datën 4.6.2008, nga huadhënësi dhe bashkëshortja e tij, duke marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme në kuptim të ligjit dhe shpenzimet për periudhën deri në momentin e dhënies së huas.

30.36 Për të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i znj. Sh.H, Komisioni verifikoi dokumentacionin e administruar në dosje deri në vitin 2008, vit në të cilin është dhënë huaja.

²⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 16.9.2022.

²⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2022.

²⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2022.

²⁹Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 21.9.2022, si dhe provat e ardhura me postë me shkresat nr. ** prot., datë 21.9.2022; nr. ***prot., datë 26.9.2022; nr. *** prot., datë 18.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 5.12.2022: kontratë me A.K të P dhe znj. Sh.H, sipas së cilës znj. Sh.H blen truallin nën objekt dhe sipërfaqe funksionale të objektit me sip. 20.9 m² tek “R.P”, Durrës, në datën 5.10.1999, në shumën 33.440 lekë; shkresë nr. *** prot., datë 23.9.2022, 1 fletë, e ISSH-së, për shtetasit H dhe Sh.H; mandatpagesë kontributesh shoqërore 16 fletë (në total) për znj. Sh.H dhe 1 për z. H.H; kopje e një deklarate dore, blerje nga z. H.I, i cili deklaroi se ka blerë nga z. H.H barakën që ka në afërsi të shkollës industriale me dimensione 2 x 2.5 m² = 5 m², në shumën 47.000 lekë, në datën 22.5.1995; vendim regjistrimi si person fizik datë 12.4.2005, me të cilin është regjistruar znj. Sh.H.H për aktivitet privat “tregti artikujsh të ndryshëm industrialë me pakicë”; ekstrakt regjistrimi datë 19.9.2022, sipas të cilit rezultoi se personi fizik në emër të znj. Sh.H është me status të çregjistruar; ekstrakt historik sipas të cilit rezultoi se personi fizik Sh.H është regjistruar në datën 18.5.2005, me aktivitet “tregti artikujsh të ndryshëm industrialë”. Aktiviteti është pezulluar në datën 21.1.2009 dhe në datën 18.5.2010 është çregjistruar; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.9.2022, Dega e Fondit Arkivor të Kontributeve për shtetasit H e Sh.H; shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, ku referohen në ardhurat e deklaruara nga znj. Sh.H, për vitet 2005, 2006 dhe 2016 – 2019. Referuar kësaj shkrese rezultojnë të ardhura të deklaruara, por nuk ka të dhëna për fitim të deklaruar nga znj. H; shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, ku referohet se nga verifikimi i të dhënave për aktivitet të ushtruar nga znj. Sh.H figuron një aktmarrëveshje ortakërie ndërmjet 5 personave, ku do të punonin në një ortakëri me aktivitet të bufesë dhe pastërisë; nxjerrje llogarie në “Tirana Bank” z. H.H, datë 5.12.2022, 20 fletë; nxjerrje llogarie në “Tirana Bank” z. H.H, datë 5.12.2022, 4 fletë; kontratë shitjeje nr. **, datë 5.10.1999; aktpjesëtimi vullnetar nr. *** regj., datë 10.1.1996; kontratë dhurimi nr. ***, datë 19.2.2020; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.6.2014; kontratë shitblerjeje datë 24.9.1993.

30.37 Subjekti gjatë hetimit ka depozituar dokumentacion në lidhje me pagesat e kontributeve shoqërore të sigurimeve, të kryera nga znj. Sh.H për vitet 1994 – 1998. Për Komisionin, këto mandatarkëtime nuk u konsideruan të mjaftueshme për të provuar fitimin *neto* të aktivitetit tregtar.

30.38 Referuar dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se znj. Sh.H ka pasur një aktivitet bar-bufe të regjistruar me NIPT në vitin 2005.

30.39 Duke qenë se informacioni i vënë në dispozicion nga tatimet specifikon vetëm shumën e të ardhurave të deklaruar për vitet 2005 dhe 2006, Komisioni përlllogariti një fitim të mundshëm duke aplikuar një marzh fitimi në masën 40%. Pas përlllogaritjeve duket se fitimi *neto* për këtë periudhë do të rezultonte në shumën 1.520.000 lekë.

30.40 Nga verifikimi i të dhënave bankare të shtetasve H dhe Sh.H ka rezultuar se këta shtetas kanë disponuar një depozitë bankare në “Tirana Bank” në shumën 1.500.000 lekë, në vitin 2006. Fondet në depozitë janë shtuar rregullisht dhe deri në vitin 2008 dhe përpara dhënies së huas kjo depozitë ishte në shumën 2.220.943 lekë. Depozita nuk është prekur nga titullarët e saj deri në vitin 2014 dhe me anë të një transferte bankare të datës 10.6.2014 janë transferuar në llogarinë e shtetasit me inicialet S. Gj. Pra, këto fonde të akumuluar në vite janë përdorur nga huadhënësit për blerjen e një apartamenti në shumën 2.800.000 lekë në pronësi të tyre dhe, për rrjedhojë, nuk mund të jenë përdorur si burim për huan e dhënë.

30.41 Sipas rezultateve të hetimit administrativ, analiza financiare mbi mundësitë e huadhënësit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për dhënien e huas në shumën 4.800.000 lekë, në vitin 2008 dhe, për pasojë, analiza e kryer për blerjen e apartamentit ka rezultuar me një balancë negative në shumën 6.329.226 lekë.

Shlyerja e huas

31. Në lidhje me shlyerjen e huas subjekti në deklaratimet në vite ka deklaruar shumat e shlyera. Në dosje rezultojnë edhe aktet “mandatarkëtimi”, kopje të njëjta me origjinalin. Nga analizimi i “mandatarkëtimeve” në lidhje me kthimin e huas te huadhënësi ka rezultuar se shuma totale e shlyerjeve në vite, sipas mandateve të depozituara nga subjekti, është në shumën 3.650.000 lekë, ndërsa referuar deklaratimeve periodike vjetore për vitet 2010 – 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e huas në shumën 4.800.000 lekë.

Konstatime të Komisionit

32. Nga hetimi i Komisionit për pasurinë apartament në Tiranë rezultoi:
- mungesë burimesh të ligjshme për kursimet e deklaruar deri në vitin 2007;
 - mungesë burimesh të ligjshme për dhuratën e vjehrrit në shumën 3.000 euro;
 - mungesë burimesh të ligjshme për huan e dhënë në shumën 4.800.000 lekë;
 - në lidhje me kthim e huas nuk përputhen shumat e deklaruar nga subjekti sipas DPV-ve, me mandatarkëtimet e depozituara;
 - nga analiza financiare e kryer ka rezultuar një mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 6.329.226 lekë.

32.1 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime³⁰ të rezultateve të hetimit, ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit ku, ndër të tjera³¹, ka ngritur disa pretendime.

a/1. Për kursimet *cash* të deklaruar në vitin 2003, ku në rezultatet e hetimit ka rezultuar pamjaftueshmëri burimesh në shumën 580.774 lekë, subjekti ka dhënë shpjegimet vijuese:

33.1 Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën 1994 – 2003, nuk janë përfshirë të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit të familjes sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 14.11.1996, ku si bashkëpronarë në këtë pasuri rezultojnë të kenë qenë prindërit dhe subjekti. Ky apartament është shitur në shumën 1.550.000 lekë. Subjekti ka pretenduar se nga kjo shumë janë investuar te firmat piramidale:

- “Xh”, shuma 250.000 lekë dhe kanë përfituar interesa në shumën 130.000 lekë;
- “P”, shuma 400.000 lekë dhe kanë përfituar interesa në shumën 240.000 lekë.

33.2 Për shumat e investuara në firmat piramidale kanë përfituar të ardhura (interesa), por pa mundur t’i dokumentojë ato. Subjekti pretendon se nga shitja e shtëpisë ka humbur vetëm shumën 320.000 lekë në firmat piramidale dhe ka kërkuar nga Komisioni që në analizën financiare për periudhën 1994 – 2003, ku janë përfshirë të ardhurat e të gjithë familjes së tij të origjinës, të përfshihet shuma 1.230.000 lekë, e krijuar nga shitja e apartamentit, si e ardhur e ligjshme.

33.3 Në vijim, subjekti ka pretenduar se në të ardhurat e subjektit për pagat për periudhën 1993 – 2004, të pasqyruara në analizën e Komisionit, ka një lapsus në llogaritje, pasi të ardhurat e tij nuk janë sa i ka llogaritur Komisioni në shumën 2.111.242 lekë, por janë në shumën 2.157.945 lekë. Subjekti ka kërkuar që në analizë të përfshihet shuma e saktë.

³⁰Dokumente të depozituar nga subjekti për pasurinë: vërtetim i K për të D e I dhe M e të dhënave personale, 13 fletë; dokumente italiane të shtetasës B.H, 45 fletë; vërtetim i shoqërisë “****” sh.p.k., datë 13.1.2023, 1 fletë; vendim nr. *, datë 15.6.2005, 1 fletë, i administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k.; listëpagesa të kontributeve të sigurimeve shoqërore të të punësuarve në shoqërinë “****” sh.p.k., 6 fletë; shkresë nr. ** prot., datë 6.1.2023, e Entit Kombëtar të Banesave (Drejtoria Rajonale Tiranë, 1 fletë, bashkëlidhur kalendari i shlyerjeve; vërtetim datë 23.11.2022, lëshuar nga prof. dr. V.H; shkresë nr. *** prot., datë 9.1.2023, 1 fletë, nga Drejtoria Rajonale Durrës, dega e arkivit; vërtetim nr. *, datë 9.1.2023, i Drejtorisë Rajonale Durrës, dega e arkivit, 1 fletë; vërtetim për bazën e vlerësueshme për periudhën 1.1.1992 – 1.1.1996, 1 fletë; vërtetim për bazën e vlerësueshme për periudhën 1.1.1998 – 28.2.1999, 1 fletë; shkresë nr. ** prot., datë 4.1.2023, 21 fletë, e DTTV Bashkia Durrës; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* të znj. L.L, lëshuar nga sh e të m Tiranë për periudhën 1.1.1999 - 16.2.2000, 1 fletë; vërtetim për bazën e vlerësueshme Bashkia Kolonjë (ish-Komuna Ç) për periudhën 1.1.1994 – 15.12.1996, 1 fletë; shkresë nr. *** prot., datë 6.6.2022, e shoqërive huamarrëse në administrim, 1 fletë; shkresë nr. * prot., datë 10.12.2023, e shoqërive huamarrëse në administrim, 8 fletë; shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2022, 1 fletë, e Bankës Kombëtare Tregtare; shkresë nr. *** prot., datë 5.12.2022, 1 fletë, e “Raiffeisen Bank”; vërtetim nr. *** prot., datë 14.12.2022, 1 fletë, i Fakultetit të Drejtësisë; kontratë e depozitës me afat për *** disaemërore nr. ***, datë 14.2.2020, 4 fletë; mandatarëkëtimi i “Credins Bank”, datë 14.2.2020, 1 fletë; nxjerrje llogarie datë 14.2.2022, 1 fletë; nxjerrje llogarie datë 9.1.2023, 1 fletë; shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2022, 17 fletë, nga ISSH-ja; dokument nxjerrë nga faqja e internetit të * for ** and **, datë 30.1.2008, 5 fletë; Summer School Program 2007, 1 fletë.

³¹Për më tepër, referojuni prapësimeve të subjektit të datës 23.1.2023.

33.4 Subjekti ka pretenduar se në analizën e Komisionit nuk janë përfshirë të ardhurat e fituara nga botimi në vitin 2001 të librit “Komentari i Kodit Penal Ushtarak”, nga shtëpia botuese “A”, me bashkautor A.H.

33.5 Ky libër është financuar nga P i L i F “S” dhe ka dalë në shtyp me një tirazh 1000 kopje, me çmimin 600 lekë. Nga ky libër autorët kanë përfituar shumën 223.950 lekë, fakt që vërtetohet me aktmarrëveshjen e datës 12.10.2001, të lidhur ndërmjet shtëpisë botuese “A” dhe z. Altin Shkurti. Në këtë marrëveshje përcaktohet fitimi (*neto*) i autorëve në shumën 223.950 lekë. Subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është përfituar e gjitha prej tij, pasi bashkautori tjetër A.H, në vitin 2000, është larguar nga Shqipëria për të jetuar në Kanada dhe ky botim është përfunduar prej subjektit.

33.6 Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni duhet të përfshijë në analizë shumën 630 USD të përfituar nga angazhimi i tij në projektin “I.C(Victim) S in Albania”, në periudhën 1995 – 1996, me koordinatorë prof. dr. V.H. Ky fakt provohet sipas vërtetimit të datës 23.11.2022, lëshuar nga znj. V.H, sipas të cilit provohet se subjekti është angazhuar në këtë projekt me cilësinë e intervistuesit dhe është paguar për këtë punë në shumën *neto* 630 USD (64.260 lekë).

33.7 Subjekti ka kërkuar se për llogaritjen e shpenzimeve³² të jetesës për periudhën 1994 – 1999, Komisioni ka llogaritur shpenzimet e jetesës në masën 66% të të ardhurave, ndërkohë që subjekti pretendon se gjatë kësaj periudhe ka qenë student dhe shpenzimet e jetesës së tij duhet të llogariten në masën 30%, bazuar kjo në standardin e mbajtur nga Kolegji në raste analoge.

33.8 Subjekti ka pretenduar se nëse do të merreshin në konsideratë pretendimet e tij sa më sipër, do të rezultonte se kishte mjaftueshëm të ardhura për periudhën 1994 – 2003, për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1.100.000 lekë.

a/2. Subjekti, gjithashtu, përveç shpjegimeve të tij për kursimet e krijuara në periudhën 1994 – 2003, për periudhën vijuese ka referuar se për deklaratimet e kursimeve *cash* në DPV-të e viteve 2004 – 2007, ka pretenduar se gjendjet *cash* të deklaruara çdo vit, të reflektuara në analizën e Komisionit, nuk janë reflektuar saktë për arsye se subjekti i ka deklaruar si kursime *cash* dhe në bankë. Për këtë arsye ka kërkuar saktësimin e këtyre shumave në analizë, sipas shpjegimeve të tij.

Vlerësimi i Komisionit për pasurinë apartament

34. Komisioni, pas një hetimi të thellë administrativ në lidhje me burimet e krijimit për pasurinë apartament, analizoi shpjegimet e subjektit në prapësime, provat e depozituara në mbështetje të barrës së provës, si dhe çdo pretendim të ngritur prej tij.

a/1. Në lidhje me kursimet *cash* të subjektit për periudhën 1994 – 2003, Komisioni, pas analizimit të provave dhe pretendimeve të subjektit, vëren se:

34.1 Në lidhje me pretendimet e subjektit se Komisioni në analizën financiare duhet të përfshijë shumën 1.230.000 lekë si të ardhura të krijuara nga shitja e një apartamenti, sipas kontratës së shitjes datë 14.11.1996, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i

³²Ky pretendim është paraqitur nga subjekti dhe për analizat financiare të kryera nga Komisioni kur ka trajtuar mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur dhuruesit/P.L dhe huadhënësit/H.H.

subjektit nuk qëndron për të gjithë shumën, për aq kohë sa vetë subjekti ka deklaruar se një pjesë e tyre është investuar në firmat piramidale, respektivisht shuma 250.000 lekë investuar tek firma “Xh” dhe shuma 400.000 lekë investuar tek firma “P”. Në këto rrethana, Komisioni çmoi të reflektojë në analizë shumën 800.000 lekë, si shumë e mbetur pas investimit në firmat piramidale, si një e ardhur e ligjshme e krijuar nga shitja e një pasurie në bashkëpronësi të subjektit me prindërit e tij.

34.2 Në lidhje me pretendimin e subjektit se tek të ardhurat nga pagat për periudhën 1993 – 2004 ka një lapsus në llogaritje, nga verifikimet e akteve, pas prapësimeve, Komisioni e vlerësoi të drejtë këtë pretendim, duke reflektuar në analizë këto të ardhura, referuar dokumentacionit provues të administruar në dosje.

34.3 Në lidhje me pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizë të ardhurat e përfituara nga botimi i librit “Komentari i Kodit Penal Ushtarak”, trupi gjykues vlerëson se referuar dokumentacionit të administruar në dosje nuk u provua se këto të ardhura përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.

34.4 Në lidhje me pretendimin e subjektit se ka përfitur të ardhura nga angazhimi i tij në projektin “I.C(V) S in Albania”, 1995 - 1996, subjekti nuk provoi se këto të ardhura përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.

34.5 Në lidhje me pretendimin e subjektit se për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1994 – 1999 të llogariten në masën 30%, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni, referuar kjo edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit³³, ku është parashikuar se *shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999 janë llogaritur në masën 66% të të ardhurave*. Mbi këtë parashikim, Njësia e Shërbimit Ligjor kryen analizën financiare. Për pasojë, pretendimet e subjektit nuk merren për bazë dhe analiza financiare nuk pësoi ndryshime mbi këtë pretendim.

34.6 Sa më sipër, analiza pas prapësimeve në lidhje me kursimet *cash* për periudhën 1994 – 2003 ka rezultuar me një balancë pozitive, sipas tabelës vijuese.

Përshkrimi	Periudha 1994 – 2003
Të ardhura nga shitja e shtëpisë	800 000
Të ardhura nga magjistratura 1997 – 1999	360 508
Të ardhura nga paga 2000 – 2003	2 116 330
Të ardhura nga trajnime	29 344
Të ardhura babai 1994 – 2003	756 985
Të ardhura totale	4 063 166
Shpenzime jetese 1994 – 1999	429 997
Shpenzime qiraje 1999 – 2003	600 000
Shpenzime jetese 2000 – 2003 (4 persona)	1 458 825
Shpenzime totale	2 488 822

³³Sipas vendimit nr. 30/2018 (JR), datë 26.7.2019, për subjektin N. K.

Mundësi për kursim	1 574 344
Blerje automjeti	250 000
Cash i deklaruar në vitin 2003	1 100 000
Rezultati	224 344

a/2. Në lidhje me pretendimet e subjektit për kursimet *cash* të deklaruara prej tij në DPV-të e viteve 2004 – 2007, Komisioni, pasi verifikoi të dhënat bankare, evidentoi se një pjesë e kursimeve janë depozituar në bankë. Referuar deklarimeve periodike për vitet 2005 dhe 2006, subjekti ka deklaruar kursime *cash* dhe pjesërisht në bankë. Kjo situatë faktike çmohet e drejtë dhe në analizën financiare janë përlogaritur diferencat e krijuara nga shumat totale të kursimeve të deklaruara me gjendjet në bankë në fund të viteve.

b. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës lidhur me dhuratën në shumën 3.000 euro

34.7 Në prapësime, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të dhuruesit (vjeherri) për periudhën 1993 – 2007, për shumën e dhuruar 3.000 euro, duke pretenduar se:

i) Në analizën financiare të Komisionit, tek të ardhurat e familjes së bashkëshortes nuk janë përfshirë të ardhurat nga pagat e nënës së bashkëshortes së subjektit, znj. L.L:

- për periudhën 1994 – 1996 në shumën 196.047 lekë;
- për periudhën 1999 – shkurt 2000 në shumën 25.324 lekë.

Subjekti ka kërkuar që këto të ardhura të pasqyrohen në analizën financiare të familjes së bashkëshortes.

ii) Në analizën financiare të kryer për këtë periudhë subjekti ka pretenduar se Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat nga paga e bashkëshortes D.L, të krijuara nga punësimi i saj në periudhën 2005 – 2007, në shumën 614.942 lekë. Këto janë të ardhura të ligjshme të krijuara nga punësimi i bashkëshortes së subjektit dhe në këtë periudhë ajo ka jetuar në familjen e prindërve dhe, për rrjedhojë, duhet të përfshihet në analizën financiare të familjes së saj.

iii) Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se në datën 3.6.2005 vjeherri i tij, z. P.L, ka marrë nga OTP Bank (ish-Banka Popullore) një kredi në shumën 500.000 lekë. Në këtë periudhë shtetasi P.L ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k. dhe kjo kredi është paguar nga punëdhënësi, provuar ky pretendim sipas vendimit nr. **, datë 15.6.2005, të administratorit të kësaj shoqërie, z. A.V.

Subjekti ka shpjeguar se referuar shkresës nr. *** prot., datë 23.3.2021, të OTP Bank, nga *statementi* bankar rezulton se pagesat për llogari të kësaj kredie janë bërë nga punonjësit e shoqërisë “****” sh.p.k., si financierja Sh.H, shoferi A.Ç dhe ortaku i shoqërisë e në të njëjtën kohë edhe administratori A.Gj. Referuar listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 22 korrik – dhjetor 2005 rezultojnë punonjës të kësaj shoqërie shtetasit Sh.H, A.Ç, vjeherri i subjektit P.L, si dhe administrator, njëkohësisht edhe ortaku i saj A. Gj.

Për këtë shkak, subjekti ka pretenduar se nga analiza financiare e Komisionit duhet të hiqen shpenzimet për pagesën e kësteve të kësaj kredie.

iv) Subjekti ka pretenduar se në zërin e shpenzimeve për vitin 2007 janë bërë disa lapsuse:

- Shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë llogaritur gabim, pasi janë përcaktuar në shumën 235.968 lekë (për 1 person). Kjo shumë i referohet tabelave të ILDKPKI-së, ku për vitin 2007 është bërë një gabim, pasi në këtë vit shpenzimet janë llogaritur dyfishi i vitit pararendës 2006 dhe pasrendës 2008. Për shkak të këtij gabimi subjekti ka kërkuar nga Komisioni që shuma e shpenzimeve të jetesës për 1 person duhet të përlllogaritet sa në vitin pararendës, në shumën 109.557 lekë.

- Për vitin 2007, në zërin e shpenzimeve sipas sistemit TIMS, duhet të ulen disa shpenzime udhëtimi, të cilat subjekti apo bashkëshortja kanë udhëtuar vetëm (jo të dy bashkë), si dhe duhet të ulen shpenzimet për të cilat janë mbuluar nga organizatorët. Në total duhet të zbriten si shpenzime sipas sistemit TIMS shuma prej 74.359 lekësh (595 euro).

Vlerësimi i Komisionit për dhuratën në shumën 3.000 euro

35. Trupi gjykues vëren se pretendimet e ngritura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, të cilat vijnë të mbështetura në prova, çmohen të drejta dhe duhen reflektuar në analizë financiare, konkretisht:

35.1 Të ardhurat e ligjshme nga punësimi i shtetasës L.L për periudhën e punësimit 1994 – 1996, si e punësuar në Bashkinë Kolonjë, në shumën 196.047 lekë, si dhe të ardhurat e saj nga punësimi në Sh e të M.T, në shumën 25.324 lekë, për periudhën 1999 – shkurt 2000.

35.2 Për pretendimin e subjektit që në analizën financiare të familjes së bashkëshortes të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes D.L nga punësimi i saj, duke qenë se gjatë këtyre viteve ka banuar me prindërit, ky pretendim i subjektit konsiderohet i drejtë. Për rrjedhojë, në analizën financiare të Komisionit, kur vlerësohet mundësia e prindërve të bashkëshortes për dhurimin e shumës 3.000 euro, janë përfshirë edhe të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të realizuara nga punësimi i saj në vitet 2005 – 2007 në shumën 614.942 lekë, si dhe duke zbritur shpenzimet jetike për të.

35.3 Subjekti ngre pretendimin se shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë shumë të larta krahasuar me vitin paraardhës e pasardhës dhe kërkon korrigjimin e këtyre shpenzimeve. Trupi gjykues argumenton se shpenzimet jetike llogariten bazuar në përcaktimet e ILDKPKI-së sipas viteve, standard ky i aplikuar për të gjithë subjektet e rivlerësimit dhe qëndrim i konfirmuar nga praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të pranohet.

35.4 Në lidhje me korrigjimin e shpenzimeve sipas sistemit TIMS për vitin 2007, për 2 udhëtime, ku ka saktësuar se janë kryer vetëm nga subjekti apo bashkëshortja e tij dhe jo bashkë, si dhe këto udhëtime janë mbuluar nga organizatorët, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit rezulton i provuar bazuar në shkresat e lëshuara nga

organizatorët³⁴, ku evidentohen se shpenzimet janë mbuluar nga institucionet përkatëse. Për pasojë, këto ndryshime janë reflektuar në analizën financiare pas prapësimeve.

35.5 Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe provave të depozituara prej tij, Komisioni kreu analizën financiare të familjes së bashkëshortes të subjektit, nga ku rezultoi se dispononin burime të ligjshme për dhuratën në shumën 3.000 euro, që është përdorur si burim për pagimin e këstit të parë në vitin 2007 për apartamentin.

35.6 Për pasojë, subjekti ka disponuar burime të ligjshme për të kryer pagesën prej 23.000 euro në vitin 2007, sipas tabelës vijuese.

Analiza financiare për pagesën e këstit të parë në vitin 2007

PERSHKRIMI	1994-2003	2004	2005	2006	2007
PASURI	1 350 000	300 000	350 000	185 230	861 542
Autoveture DPV 2003, blere 250.000 leke	250 000				
Apartament 2+1 109 m2					2 780 930
Banka Subjekti	-	-	214 770	203 075	15 842
Cash Subjekti	1 100 000	1 400 000	1 535 230	1 732 155	-
Shtesa/Pakesime likuiditete	1 100 000	300 000	350 000	185 230	(1 919 388)
Likuiditete Gjendje total	1 100 000	1 400 000	1 750 000	1 935 230	15 842
DETYRIME	-	-	-	-	-
PASURINETO = Pasuri - Detyrime	1 350 000	300 000	350 000	185 230	861 542
TEARDHURA	4 063 166	762 071	763 602	837 467	1 257 963
Te ardhura nga paga e subjektit	2 506 182	762 071	763 602	837 467	895 233
Dhurim nga P. L					362 730
Te ardhura babai	756 985				
Te ardhura nga shitja e shtepise	800 000				
SHPENZIME	2 488 822	153 964	178 748	169 557	350 833
Shpenzime jetese	1 888 822	93 964	109 557	109 557	235 968
Shpenzime udhetimi TIMS			9 191	-	114 865
Shpenzime qiraje	600 000	60 000	60 000	60 000	
Rezultati	224 344	308 107	234 855	482 680	45 588

c. Qëndrimi i subjektit në lidhje me huan në shumën 4.800.000 lekë

36. Subjekti në prapësime ka kundërshtuar rezultatin e analizës lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për huadhënësin H.H, duke pretenduar se huaja ka si burim të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shtetasve Sh.H (bashkëshortja e huadhënësit), puna e dy fëmijëve të tyre në emigracion, si dhe pensionet e këtyre shtetasve. Kjo hua është likuiduar plotësisht në vitet pasuese, sipas deklarimeve të subjektit.

36.1 Në lidhje me konstatimet e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme të huadhënësit H.H për t'i dhënë subjektit shumën prej 4.800.000 lekësh, ky i fundit, ndër të tjera³⁵, ka shpjeguar rrethanat si vijon:

36.2 Subjekti ka pretenduar se shtetasja Sh.H ka ushtruar aktivitetin tregtar nga viti 1993 e në vijim, pa ndërprerje, fakt ky i konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë

³⁴Udhëtimi i bashkëshortes në harkun kohor 10.3.2007 - 12.3.2007 është për shkak të punës dhe është paguar nga OSBE-ja, i cili provohet me *Statement of Earning* të OSBE-së, datë 24.11.2022, depozituar në cilësinë e provave. Ndërsa udhëtimi i subjektit në Malin e Zi në harkun kohor 22.7.2007 - 28.7.2007 ka qenë i ftuar si ekspert në shkollën verore "E.U and I.R.P", organizuar nga ***, U. D.B, The J.H.U School of A.I.S, The U of B, Faculty of Law.

³⁵Për më shumë referojuni prapësimeve të subjektit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2023.

14.11.2022, të DRT-së Durrës, ku referohet se nga verifikimi për të dhënat e aktivitetit të kësaj shtetaseje u konstatua një dosje fizike me kod fiskal ***.

36.3 Në dosje rezulton një akt me përshkrimin “aktmarrëveshje ortakërie ndërmjet D.Z dhe tre shtetaseve të tjera, ku do të punonin me ortakëri në aktivitetin ‘bufe dhe pastičeri’”. Bashkëlidhur rezulton një certifikatë ushtrimi profesioni nr. ***, ku figuron si pjesëtare edhe shtetasja Sh.H, me aktivitet “bar-bufe-restorant”, aktivitet që është ushtruar në P, Durrës. Në këtë certifikatë referohet se ky aktivitet ka filluar në bazë të vendimit të gjykatës nr. ***, datë 23.12.1991.

36.4 Në vijim, në datën 10.1.1996, bashkëpronarët që kanë privatizuar objektin ku ushtrohej ky aktivitet e kanë pjesëtuar vullnetarisht objektin me kontratën noteriale nr. *** regj., nr. ** dhe nga kjo ndarje shtetasja Sh.H ka marrë në pronësi një lokal me dy ndarje me sipërfaqe ndërtimi 20.9 m². Kjo njësi është privatizuar nga shtetasja Sh.H dhe në vijim, me kontratën e shitblerjes nr. **, datë 5.10.1999, ka blerë nga dega e AKKP-së Durrës edhe truallin nën këtë objekt. Në këtë objekt ajo ka vijuar të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar si person fizik deri në vitin 2019, kur ajo është çregjistruar, fakt që rezulton nga shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

36.5 Në vijim, subjekti ka pretenduar se për vërtetimin e faktit juridik të ushtrimit të aktiviteti tregtar nga personi fizik “Sh.H” për periudhën mars 1999 – dhjetor 2003 gjendet në pamundësi objektive për të provuar dhe referuar pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme”*.

36.6 Pavarësisht këtij fakti, duke pasur në konsideratë të dokumentuar regjistrimin në vitin 1993, vijimin e aktivitetit tregtar të dokumentuar për periudhën janar 1994 – shkurt 1999 dhe dokumentacionin ku evidentohen pagesat të sigurimeve shoqërore për vitin 2004, përpara hapjes së aktivitetit tregtar me NIPT K***S, vërtetohet se shtetasja Sh.H ka ushtruar aktivitet tregtar edhe në periudhën e ndërmjetme mars 1999 – dhjetor 2003.

36.7 Personi fizik “Sh.H” ka ushtruar aktivitetin tregtar edhe për periudhën e ndërmjetme mars 1999 – 2003. Nga provat e depozituara vërtetohet fakti i fillimit të aktivitetit tregtar në vitin 1993³⁶ dhe vijimi i ushtrimit të tij, pa ndërprerje, deri në shkurt të vitit 1999. Me vërtetimin nr. *** prot., datë 16.5.2005, të ISSH-së Durrës, rezulton se personi fizik “Sh.H” ka ushtruar aktivitetin tregtar edhe në vitin 2004. Me këto prova vërtetohet vijimësia e ushtrimit të aktivitetit tregtar të personit fizik “Sh. H”, pavarësisht mungesës së dokumentacionit zyrtar, nga viti 1993 deri në maj të vitit 2005,

³⁶Subjekti ka shpjeguar se fakti që shtetasja Sh.H ka ushtruar aktivitet për përuadhen 1993 – 2004, vërtetohet me provat vijuese: shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2022, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës; mandatpagesat e sigurimeve shoqërore të viteve 1994, 1995, 1996, 1997 dhe 1998; vërtetimin nr. *** prot., datë 16.5.2005, të Drejtorisë Rajonale Durrës të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që vërteton ushtrimin e këtij aktivitet edhe para vitit 2005.

kur ajo ka kryer regjistrimin e ri pranë Drejtorisë së Tatimeve Durrës, me NIPT K***S, me aktivitetin “industriale”, Lagjja nr. **, me kod ***, regjistruar në sistem në Bashkinë Durrës në vitin 2005.

36.8 Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me shkresën ** prot., datë 4.1.2023, deklaroi se: “...në zbatim të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011, ‘Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor’, i ndryshuar, janë falur pa pagesa në favor të buxhetit të shtetit të gjitha detyrimet tatimore të personave fizikë që i përkasin periudhës tatimore deri në 31 dhjetor 2010, ndaj nuk kemi të pasqyruar detyrimet deri në vitin 2010 për këtë subjekt”.

36.9 Subjekti ka pretenduar se shtetasja Sh.H ka ushtruar aktivitet tregtar pa ndërprerje dhe në mënyre të vazhdueshme dhe se marzhi i fitimit të saj ka qenë në masën 50% të xhiros së realizuar. Subjekti shpjegon se përpara funksionimit të sistemit elektronik C@TS subjektet tregtare pajiseshin me kod fiskal.

36.10 Subjekti ka pretenduar se lidhur me fitimin e realizuar nga personi fizik “Sh.H”, për periudhën 1993 – 2004, në mungesë të dokumentacionit zyrtar, xhiroja e tij, sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit dhe Kolegjit, duhet të llogaritet në shumën minimale të fashës zyrtare të përcaktuar për këtë lloj aktiviteti tregtar, në shumën 2.000.000 lekë për çdo vit, me një fitim në masën 50% të xhiros, nga ku rezulton se personi fizik “Sh.H” ka realizuar një fitim në shumën 12.000.000 lekë. Në arritjen e këtij konkluzioni duhet të mbahet në konsideratë vendi i ushtrimit të aktivitetit tregtar, i cili është në P, Durrës, buzë rrugës nacionale Durrës - Kavajë, tek rrethrotullimi aktual, ku qëndrojnë të gjithë autobusët që udhëtojnë në jug të Shqipërisë, linja urbane e qytetit Durrës - Plepa, si dhe të gjithë plazhistët që frekuentojnë plazhin gjatë sezonit të verës, duke filluar që nga Shkëmbi i Kavajës e deri në Qerret.

36.11 Referuar dokumentacionit për vitet 2005 - 2006, shtetasja Sh.H ka realizuar të ardhura sipas dokumentit të provuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me nr. ***, datë 3.10.2022.

36.12 Në vijim, edhe për vitet 2007 dhe 2008 subjekti ka pretenduar se shtetasja Sh. H ka realizuar të ardhura dhe ka paguar taksat vendore, sipas detyrimeve përkatëse. Kështu që personi fizik për vitin 2007 ka paguar taksë biznesi në shumën 83.000 lekë. Referuar aneksit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 5 e nenit 3 të këtij ligji, parashikohet se: “5. Nivel tregues i taksës është niveli i taksës mbi biznesin e vogël, i parashikuar në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji pagim takse 83.000 i referohet fashës së xhiros 3.000.000 – 4.000.000 lekë”. Referuar këtij parashikimi për vitin 2007, personit fizik “Sh.H” duhet t’i llogaritet xhiro në shumën 3.000.000 lekë dhe fitim në shumën 1.500.000 lekë.

36.13 Personi fizik “Sh.H” ka ushtruar aktivitet tregtar edhe në vitin 2008, fakt i rezultuar nga mandatarkëtimi nr. ***, datë 16.1.2009. Fakti i ushtrimit të aktivitetit tregtar në vitin 2008 vërtetohet edhe nga fleta e ndjekjes së subjektit sipas viteve, ku rezulton se ajo ka paguar këstin e parë të 1% të xhiros në shumën 5.666 lekë. Referuar faktit të pagimit të këstit të parë në shumën 5.666, rezulton se subjekti ka realizuar

xhiro në shumën 2.266.400 lekë. Për harkun kohor janar 2008 - maj 2008 subjekti tregtar “Sh.H” ka realizuar një xhiro prej 1.110.000 lekësh dhe fitim në shumën 555.000 lekë.

36.14 Subjekti ka pretenduar se totali i fitimit të personit fizik “Sh.H” nga aktiviteti tregtar për periudhën 1993 – maj 2008, duke pasur parasysh praktikën e konsoliduar të Kolegjit dhe Komisionit që për personat fizikë të merret 50% e xhiros dhe rezulton të jetë në shumën 16.288.333 lekë.

36.15 Në vijim, subjekti ka pretenduar se Komisioni në analizën financiare të kryer duhet të përfshijë si të ardhura të huadhënësit edhe të ardhurat e përfituara nga shtetasi H.H nga pensioni i tij suplementar, që fillon nga data 1.1.1999 deri më 1.6.2008. Në total, deri në momentin e dhënies së huas, huadhënësi ka pasur të ardhura nga pensioni suplementar në shumën 385.946 lekë. Këtë shumë subjekti ka kërkuar që Komisioni ta pasqyrojë në analizën financiare si të ardhura të ligjshme të huadhënësit.

36.16 Subjekti ka pretenduar se familja e xhaxhait të nënës së tij ka pasur të ardhura edhe nga fëmijët e tyre A.H dhe B.H, të cilët kanë emigruar jashtë vendit. Djali i tyre A.H ka emigruar në Gjermani që në vitin 1991, ndërsa vajza B.H ka emigruar në Itali në vitin 1999. Të dy fëmijët u kanë sjellë prindërve të tyre të ardhura të konsiderueshme.

36.17 Subjekti ka shpjeguar se shtetasi A.H, pronar dhe administrator i shoqërisë “T. P.E”, jeton në Gjermani. Ky shtetas ka lëshuar një vërtetimin të thjeshtë në datën 30.12.2022, ku deklaron se: *“Kam emigruar në Gjermani në vitin 1991 dhe me natyralizim në vitin 1999 jam bërë shtetas gjerman. Në Gjermani kam filluar punë që në vitin 1992. Në vitin 1996 kam filluar ushtrimin e biznesit piceri ‘T.P.E’.*

Në vitet 1992 – 2007, herë pas herë gjatë ardhjeve të mia në Shqipëri, nga kursimet e mia u kam sjellë prindërve të mi H dhe Sh.H një shumë rreth 30.000 euro. Kjo shumë u është dhënë për ruajtje prindërve të mi H dhe Sh.H. Jam vënë në dijeni nga prindërit e mi se ata i kanë dhënë një hua në shumën 4.800.000 lekë kushëririt tim Altin Shkurti, e cila është kthyer plotësisht nga ai. Në dhënien e kësaj huaje prindërit më kanë bërë me dije se kanë përdorur edhe kursimet e mia, të sipërcituara, të sjella nga unë të depozituara në banesën e prindërve. Unë kam qenë dakord, për shkak të marrëdhënieve familjare që kemi me z. Altin Shkurti”.

36.18 Për të vërtetuar të ardhurat e tij të ligjshme, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës³⁷ bilancet e aktivitetit tregtar të shoqërisë “T.P.E” për vitet 1996 – 2001 dhe 2003 – 2007, ku referuar këtyre dokumenteve rezulton se nga ky aktivitet tregtar në

³⁷Aktet provuese: pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 1996; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 1997; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 1998; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 1999; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2000; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2001; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2003; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2004; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2005; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2006; pasqyrat financiare të firmës “P.E”, me pronar z. A.H, viti 2007; vërtetim i lëshuar nga z. A.H, datë 30.12.2022, 1 fletë; letërnjoftim i z. A. H, 2 fletë.

emër të shtetasit A.H janë realizuar të ardhura në shumat 117.000 euro dhe 215.908 marka gjermane.

36.19 Në vijim, subjekti ka pretenduar se edhe vajza e huadhënësit, znj. B.H, ka qenë emigrante në Itali. Në mbështetje të këtij fakti, kjo shtetase ka lëshuar një deklaratë, sipas së cilës referon se: *“Kam qenë emigrante në Itali në vitet 1999 – 2009. Në vitet 2004 – 2007 kam punuar si babysiter për rritjen e dy fëmijëve të z. A.S dhe kam jetuar në banesën e tij. Nga emigracioni në vitet 1999 – 2009, gjatë vizitave që kam bërë në Shqipëri deri në vitin 2007, kam sjellë në shtëpi shumën 20.000 euro. Kjo shumë u është dhënë për ruajtje prindërve të mi H dhe Sh. H. Jam vënë në dijeni nga prindërit e mi se ata i kanë dhënë një hua në shumën 4.800.000 lekë z. Altin Shkurti, e cila është kthyer plotësisht nga ai. Në dhënien e kësaj huaje prindërit më kanë bërë me dije se kanë përdorur edhe kursimet e mia të sjella nga emigracioni. Unë kam qenë dakord, për shkak të marrëdhënieve familjare që kemi, ku unë e kam si vëlla z. Altin Shkurti”.*

36.20 Subjekti ka depozituar dokumentacion në gjuhën italiane dhe të përkthyer për shtetasen B.H, 45 fletë, me përshkrimin “llogari rrjedhëse postare – librezë derdhje”.

36.21 Në lidhje me kërkesën e Komisionit për të provuar të ardhurat *neto* të shtetasës B.H, subjekti ka shpjeguar se është në pamundësi për të siguruar dokumentacion, pasi kjo shtetase banon në Shqipëri që në vitin 2009 dhe nuk ka mundësi të aksesojë të dhënat (kodin përkatës) për të hyrë në sistemin italian INPS.

Vlerësimi i Komisionit për huan në shumën 4.800.000 lekë

37. Trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit në prapësime, si dhe me dokumentacionin mbështetës të depozituar prej tij, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, në analizë edhe të gjithë dokumentacionit të administruar në dosje, arsyeton se:

37.1 Në lidhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për huan e marrë nga personi tjetër i lidhur/shtetasi H.H, në një vlerësim të përgjithshëm konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi marrjen e kësaj huaje në shumën 4.800.000 lekë në deklaratën *Vetting*, duke e përcaktuar atë si burim specifik për krijimin e pasurisë apartament, në përputhje me ligjin nr. 84/2016. Më tej, subjekti po në deklaratën *Vetting* 2017, në mënyrë shteruese ka referuar kontratën e huas datë 4.6.2008, si dhe e ka deklaruar këtë kontratë huaje në DIPV/2008 dhe, më tej, në vitet në vazhdim ka deklaruar përdorimin e kësaj shume të marrë hua për pagimin e detyrimit të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin. Gjithashtu rezulton se sipas DIPV/2010 dhe në vazhdim, subjekti ka deklaruar gjithashtu shlyerjen e kësaj huaje, si dhe ka paraqitur mandatpagesë, duke formalizuar shlyerjen e huas, marrë shtetasit H.H.

37.2 Lidhur me deklarin në DPV/2008 konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar marrjen e huas për herë të parë në këtë deklaratë, në seksionin “detyrimet ndaj të tretëve”, ku qartësisht përcakton se është shpenzuar në vitin 2008 vetëm vlera

4.000 euro nga huaja e marrë në shumën 4.800.000 lekë, por nuk deklaroi gjendje jashtë sistemit bankar *cash* në DPV/2008. Gjithsesi, trupi gjykues, pasi mori në analizë faktet dhe rrethanat lidhur me huan e marrë nga subjekti në shumën 4.800.000 lekë nga shtetasi H.H, si dhe duke marrë në konsideratë deklarin e kryer nga vetë subjekti në vitin 2008, në seksionin “detyrime” *se nga shuma e marrë hua ka përdorur vetëm vlerën 4.000 euro*, e lexuar në harmoni me deklarin e bërë në vitin 2009, se si burim për këstin e tretë pagesë e apartamentit ka shërbyer gjendja *cash* nga teprica e huas prej 4.800.000 lekësh, krijon bindjen se si burim për pagimin e shumës 30.000 euro ka shërbyer huaja e marrë në vitin 2008, edhe pse nuk është deklaruar në gjendje *cash* në vitin 2008, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

37.3 Në vlerësim të përgjithshëm të deklarinave të subjektit mbi këtë hua, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka bërë deklarime të sakta dhe të plota lidhur me marrëdhënien e huas me personin tjetër të lidhur/H.H, të cilat rezultojnë në përputhje dhe me faktet e pasqyruara në kontratën e huas dhe mandatet e shlyerjes së huas dhe si të tilla, janë lehtësisht të kontrollueshme nga pikëpamja e deklarinave për Komisionin.

37.4 Më tej, lidhur me mundësinë e krijimit të shumave të dhëna hua të personit tjetër të lidhur/H.H dhe familjes së tij, Komisioni analizoi: (i) të ardhurat e ligjshme të huadhënësit nga biznesi familjar, pagat dhe pensionet; (ii) të ardhurat e bashkëshortes së huadhënësit shtetases Sh.H; (iii) të ardhurat e ligjshme të djalit të huadhënësit, të përfituara nga biznesi i tij, në Gjermani.

37.5 Lidhur me të ardhurat e huadhënësit/H.H Komisioni ka marrë në konsideratë për efekt të analizës financiare të ardhurat e përfituara nga pensioni suplementar për periudhën 1992 – 2008 në shumën 1.820.672 lekë, provuar me dokumentacion ligjor justifikues.

37.6 Lidhur me të ardhurat e ligjshme të përfituara nga bashkëshortja e huadhënësit/Sh. H, Komisioni vlerëson se nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, nga të cilat përftohen informacionet që lidhen me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar, si edhe ato të krijuara nga pagat për të cilat janë paguar sigurimet shoqërore si vijon:

i) Shtetasja Sh.H(bashkëshortja e z.H.H) ka qenë pjesë e një “aktmarrëveshjeje” ndërmjet saj dhe tre ish-punonjësve të ish-Ndërmarrjes Shtetërore P, Durrës, lidhur më 5.2.1993, ku do të punonin me ortakëri me aktivitet “bar-bufe dhe pastičeri”, referuar përgjigjes nr. *** prot., datë 14.11.2022, të DRT-së Durrës. Nga përmbajtja e akteve ka rezultuar se ky aktivitet është regjistruar në bazë të vendimit nr. ***, datë 23.12.1991 të Gjykatës.

ii) Shtetasja Sh.H ka derdhur kontributet nga aktiviteti tregtar për vitet 1994 – shkurt 1999, sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.1.2022, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

iii) Shtetasja Sh.H ka kryer regjistrimin pranë Drejtorisë së Tatimeve Durrës me NIPT K***S me aktivitetin “industriale”, Lagjja nr. **, me kod postar *** dhe është regjistruar në Bashkinë Durrës, në vitin 2005 dhe ka realizuar të ardhura sipas dokumentit të provuar nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore me nr. ***, datë

3.10.2022, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit, që krijojnë bindjen se kjo shtetase ka ushtruar një aktivitet tregtar të vazhdueshëm, të shtrirë në vite.

iv) Shtetasja Sh.H ka realizuar të ardhura dhe ka paguar taksa vendore për vitet 2007 dhe 2008, të ardhura të ligjshme në shumën 1.760.000 lekë, sipas provave shkresore të dërguara në prapësime nga subjekti i rivlerësimit.

v) Shtetasja Sh.H ka provuar se ka kryer pagesa të kontributeve të sigurimeve shoqërore për vitet 1994 – shkurt 1999³⁸, fakt që tregon se shtetasja Sh.H ka vijuar aktivitetin tregtar për këtë periudhë, pavarësisht se nuk ka dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e krijuara.

37.7 Në këto rrethana, Komisioni, për një vlerësim sa më objektiv, ka vendosur të përlllogarisë një pagë minimale për këtë periudhë dhe këto të ardhura të reflektohen në analizën financiare, qëndrim ky edhe në mbështetje të arsytimit të Kolegjit në vendim nr. 6/2022 (JR), datë 17.3.2022, ku arsyetohet se: “...bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, ‘Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë’ (i ndryshuar), për të qenë subjekt i skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror, një person duhet të ketë statusin e personit ekonomikisht aktiv, si rrjedhojë e njëjës prej formave/mënyrave të punësimit që mund të jenë vetëpunësimi apo punësimi si punëmarrës...”. Për pasojë, Komisioni ka përfshirë në analizë të ardhurat e fituara nga shtetasja H, mbi bazën e së cilës janë paguar kontributet.

37.8 Bazuar në provat e administruara në procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni mori në konsideratë për efekt të analizës financiare: (i) të ardhurat nga pagat për periudhën 1994 – shkurt 1999 të Sh.H në person fizik në shumën 260.088; (ii) të ardhura nga pensioni Sh. H për periudhën 1999 – 2008, në shumën 816.334 lekë; dhe (iii) të ardhura nga aktiviteti 2005 – qershor 2008, vërtetuar me dokumentacion ligjor justifikues në shumën 3.280.000 lekë.

37.9 Lidhur me të ardhurat e ligjshme të përfituara nga të ardhurat nga puna e djalit të z. H.H në Gjermani, Komisioni konstaton se shtetasi A.H, djali i huadhënësit, emigrant në Gjermani, ka konfirmuar se për periudhën 1992 – 2007 i ka sjellë prindërve të tij shumën 30.000 euro, me burim nga aktiviteti tregtar i ushtruar prej tij piceri “T.P.E”, në Gjermani. Për këtë shtetas janë depozituar bilancet e aktivitetit të tij tregtar “T.P.E” të viteve 1996 – 2001 dhe 2003 – 2007, ku referuar këtyre dokumenteve rezulton se për vitet 1996 – 2007 ka realizuar të ardhura në shumat 117.000 euro dhe 215.908 marka gjermane.

37.10 Në analizë të dokumentacionit të përcjellë nga ky shtetas, Njësia Ligjore pranë Komisionit kreu analizën financiare nga ku rezultoi se ky shtetas ka pasur mundësi për të kursyer shumën 30.000 euro, duke hequr shpenzimet jetike, sipas të dhënave të Eurostatit për shtetin gjerman. Për rrjedhojë, Komisioni mori në konsideratë edhe shumën prej 30.000 euro të djalit të huadhënësit, në analizimin e mundësisë financiare

³⁸Sipas shkresës nr. * prot., datë 9.1.2023, të ISSH-së Drejtorisë Rajonale Durrës.

të huadhënësit H.H, për të dhënë hua sipas kontratës së vitit 2008 shumën 4.800.000 lekë.

37.11 Nga analiza financiare e burimeve të ligjshme të huadhënësit dhe familjes së tij të trajtuara më lart, në lidhje me huan, dhënë subjektit në vitin 2008, në shumën 4.800.000 lekë, rezultoi si vijon:

Përshkrimi	Periudha 1992 - qershor 2008
Të ardhura nga aktiviteti 2005 – qershor 2008	3 280 000
Të ardhura nga pensioni H. H 1992 – 2008	1 820 672
Të ardhura nga pensioni Sh. H 1999 – 2008	816 334
Të ardhura nga pagat 1994 – shkurt 1999 Sh. H në person fizik	260 088
Të ardhura nga i biri në Gjermani	3 803 376
Të ardhura total	9 980 470
Shpenzime jetese	3 685 798
Likuiditete në bankë	2 220 943
Hua dhënë subjektit	4 800 000
Rezultati financiar	- 726 271

37.12 Në vlerësim të situatës financiare të huadhënësit, analiza financiare paraqitet me një gjendje negative në shumën 726.271 lekë në vitin e dhënies së huas.

37.13 Gjithashtu, referuar të ardhurave të dokumentuara të huadhënësit për periudhën e analizuar, ato janë në masën e dyfishit të shumës së dhënë hua.

38. Komisioni, pas prapësimeve të subjektit, kreu analizën e përgjithshme financiare për pasurinë apartament për vitin 2009, sipas burimeve të analizuara sa më sipër.

Vitet	2007	2008	2009
Kestet paguar sipas viteve ne leke	2 780 930	1 108 643	4 581 478
Kestet ne euro	23 000	9 000	33 400
Rezultati pas analizës financiare			- 354 586

38.1 Nga analiza e kryer pas prapësimeve ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme në shumën 354.586 lekë.

38.2 Trupi gjykues, pasi vlerësoi këtë rezultat financiar, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke pasur në konsideratë saktësinë dhe plotësinë lidhur me deklarin e marrëdhënies së huas me personin tjetër të lidhur/H.H, e cila rezulton në përputhje edhe me faktet e pasqyruara në kontratën e huas dhe mandatet e shlyerjes së huas dhe, si të tilla, janë lehtësisht të kontrollueshme nga pikëpamja e deklarimeve për Komisionin, si dhe një sërë faktorësh që shoqërojnë situatën e personit tjetër të lidhur, si: (i) ekzistenca e disa burimeve që kanë mundur krijimin e të ardhurave në vite, si të ardhurat nga vajza në Itali, të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat, të ardhurat e djalit në Gjermani, të cilat janë deklaruar sipas vlerësimit të personit tjetër të lidhur; (ii) shuma monetare të depozituara në llogari, kohë para dhënies së huas; (iii) pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit për të provuar

saktësisht fitimin nga aktiviteti privat i bashkëshortes së huadhënësit, në kushtet e llojit të veprimtarisë që ajo kryente; (iv) gabime të mundshme në përllogaritje duke qenë se personat, pasuria e të cilëve është marrë në analizë, nuk kanë qenë ndonjëherë bartës të ndonjë detyrimi për deklaram pranë ILDKPKI-së; si dhe (v) kontrata e huas e nënshkruar në vitin 2008 midis subjektit dhe huadhënësit, si dhe mungesa e ndonjë *indicieje* që e bën të pabesueshme marrëdhënien e huas, arriti në konkluzionin se në vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha këtyre rrethanave, balanca negative e konstatuar në këtë rast nuk do të konsiderohet përcaktuese për provueshmërinë e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës 4.800.000 lekë dhe ajo do të konsiderohet se e kalon testin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

39. Automjet tip “Mercedes-Benz”, në përdorim, në pronësi të babait të subjektit

Hetimi i Komisionit

39.1 DPSHTRR-ja³⁹ ka konfirmuar se automjeti tip “ML”, me targa AA ***AK, rezulton në pronësi të shtetasit P.A.Sh, blerë me kontratën nr. ***, datë 13.5.2011, në shumën 900.000 lekë. Ky automjet është shitur nga babai i subjektit në vitin 2020 në shumën 4.250 euro.

39.2 DPSHTRR-ja ka konfirmuar se shtetasi Altin Shkurti nuk dispononte automjet në pronësinë e tij. Ky institucion ka depozituar aktet e automjeteve që ka pasur më parë subjekti në pronësi.

39.3 AMF-ja⁴⁰ ka informuar automjetin me targa AA **AK, i cili rezulton në pronësi të shtetasit P.A.Sh dhe me përdorues edhe shtetasin Altin Shkurti.

39.4 AMF – sistemi *online*, referuar policave të sigurimit, rezulton se për këtë automjet për disa vite rresht, përdorues figurojnë subjekti me bashkëshorten e tij. Rezulton se subjekti ka dalë shpesh jashtë shtetit me këtë automjet.

Burimet e krijimit për automjetin

39.5 Komisioni ka shtrirë hetimin për burimet e krijimit për pasurinë automjet, duke i kërkuar të dhëna institucioneve, si në vijim.

39.6 ISSH-ja⁴¹ ka depozituar të dhënat:

- për shtetasin P.Sh, i cili përfiton pension pleqërie nga maji 2004 e në vijim, me masë mujore aktuale 29.926 lekë, si dhe pension suplementar ushtarak në masën mujore aktuale 14.069 lekë;
- shtetasja L.Sh përfiton pension pleqërie nga prilli 2008 e në vijim, me masë aktuale 13.433 lekë.

Analiza financiare për automjetin

39.7 Nisur nga deklaramet e subjektit në DPV se me të ardhurat e tij ka krijuar kursime çdo vit, por edhe pas shpjegimeve të dërguara gjatë hetimit nga ana e tij, ku nuk ka kontribut për blerjen e automjetit, Komisioni, me të dhënat e administruara gjatë

³⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

⁴⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

⁴¹Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022.

hetimit, kreu analizën financiare duke përlogaritur të ardhurat në kuptim të ligjit⁴² për familjarët e subjektit dhe shpenzimet e jetesës për periudhën 2004 – qershor 2011. Kjo pasi deri në vitin 2003 u analizuan të ardhurat bashkë me subjektin (trajtuar tek pasuria e parë në këtë vendim) mbi mundësitë e krijimit të gjendjes *cash*.

39.8 Në analizë u përfshinë shpenzime qiraje për banim në masën 50%, sipas deklarimeve të subjektit, duke qenë se familjarët kanë jetuar me qira (për periudhën 1999 – maj 2006).

39.9 Shpenzimet jetike për vëllain e subjektit janë përlogaritur deri në vitin 2008, pasi është shkëputur nga trangu sipas shpjegimeve të subjektit dhe akteve në dosje.

39.10 Nga analiza financiare rezultoi se prindërit e subjektit kishin mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit, pasi rezultuan me një balancë negative në shumën 1.263.335 lekë.

39.11 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Subjekti, në lidhje me këtë pasuri, ka pretenduar se:

40.1 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se marrëdhënia me këtë automjet, send i luajtshëm në kuptim të nenit 901 e vijues të Kodit Civil dhe të ligjit nr. 84/2016, është një marrëdhënie juridiko-civile e huapërdorjes, me anë të së cilës prindi ka lejuar subjektin e rivlerësimit për shkak të marrëdhënies prind-fëmijë të përdorë këtë automjet brenda dhe jashtë vendit. Në bazë të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka plotësuar detyrimin ligjor për deklarimin e përdorimit të këtij automjeti.

40.2 Subjekti ka pretenduar se përdorimi i këtij automjeti, sipas praktikës së konsoliduar të mbajtur nga Komisioni, del jashtë kategorisë së marrëdhënieve të cilat do ta vendosnin babain e subjektit në statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ky fakt nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në përdorim, pasi do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit, si dhe nuk mund ta penalizojë atë si subjekt rivlerësimi.

40.3 Subjekti ka shpjeguar se pavarësisht faktit që përdorimi i këtij automjeti nuk përbën shkak për penalizimin e tij si subjekt rivlerësimi, ai ka shpjeguar se babai i tij ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e tij. Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, të ardhurat e përfituara nga babi i tij për periudhën 2004 – 2011 kanë një lapsus, pasi janë në shumën 1.963.326 lekë dhe jo sa janë llogaritur nga Komisioni në shumën 1.925.758 lekë. Subjekti i ka kërkuar Komisionit pasqyrimin në analizë të shumës së saktë.

⁴²Referuar pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

40.4 Të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit L.Sh për periudhën 2004 – 2011, të pasqyruara në analizë, kanë një lapsus, pasi të ardhurat e saj për këtë periudhë kanë qenë në shumën 367.507 lekë dhe jo në shumën 306.921 lekë. Subjekti i ka kërkuar Komisionit korrigjimin e kësaj shume dhe përfshirjen e shumës së saktë në analizën financiare.

40.5 Subjekti ka kërkuar të përfshihen në analizën financiare të familjes së tij të ardhurat e krijuara nga vëllai i tij për punësimin për periudhën prill 2005 – dhjetor 2006 pranë subjektit “G.E, H.R”, në shumën 417.140 lekë, sipas vërtetimeve të depozituara prej tij.

40.6 Në të ardhurat e familjes së babait për këtë periudhë duhet të përfshihet dhe të llogaritet edhe zëri “kursime progresive nga 2003, në shumën 1.024.169 lekë”.

40.7 Subjekti ka pretenduar gjithashtu se në analizën financiare të kryer nga Komisioni tek shpenzimet në zërin “pagesat për EKB” ka një lapsus në shumën e përcaktuar si pagesë kredie për periudhën 2006 – 2011. Nga shkresa nr. * prot., datë 6.1.2023, e EKB-së, rezulton se fillimi i pagesës së parë të kësaj kredie është bërë në datën 13.6.2008 dhe deri më 31.4.2011 është paguar shuma 388.546 lekë. Për këtë arsye subjekti i ka kërkuar Komisionit që të pasqyrojë në analizë shpenzimet e kredisë që nga data e saktë kur ka filluar të paguhet kjo kredi, që është 13.6.2008.

Vlerësimi i Komisionit për automjetin

41. Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit, ka hetuar në disa drejtime për të verifikuar faktet e paraqitura gjatë hetimit, së pari në drejtim të verifikimit të mundësisë së babait të subjektit (pronari i automjetit) dhe familjes së origjinës së subjektit për të blerë automjetin objekt hetimi, me të ardhura nga burime të ligjshme dhe, së dyti, në drejtim të verifikimit të deklaramentit të subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se:

- i) subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjetin në përdorim, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016;
- ii) nga policat e sigurimit provohet përdorimi i automjetit nga subjekti, si dhe ka rezultuar se është përdorur nga subjekti dhe bashkëshortja jashtë Shqipërisë, në disa udhëtime të tyre;
- iii) subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka provuar me dokumentacion të ardhura të ligjshme shtesë të familjes së tij (babait, nënës dhe vëllait).

41.1 Pas prapësimeve, referuar dokumentacionit shtesë dhe rishikimit të të ardhurave të dokumentuara gjatë hetimit për të ardhurat e familjes, u reflektuan ndryshimet në analizën financiare të Komisionit, nga ku rezultoi se prindërit kishin mundësi për blerjen e automjetit me burime të ligjshme.

41.2 Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në dosje, ka konkluduar përfundimisht se subjekti ka deklaruar saktë përdorimin e këtij automjeti në deklaratën *Vetting* dhe babai i tij në këtë marrëdhënie të afërt familjare, referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk kualifikohet në kategorinë e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur si

dhurues, huadhënës apo huamarrës, mbështetur ky arsytim edhe në qëndrime të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për çështje të njëjta⁴³.

41.3 Në vlerësim përfundimtar, lidhur me përdorimin e automjetit të babait, duke marrë në konsideratë marrëdhënien e afërt familjare, për sa kohë nga hetimi i Komisionit nuk u ngritën dyshime për pasuri të fshehura të subjektit, trupi gjykues konkludon se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në përdorim, në pronësi të babait.

DEKLARIME TË BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

42. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*:
43. Gjendje *cash* në banesë në shumën 10.800 euro, me burim krijimi kursimet nga paga dhe shpërblimet e punës së saj
44. Depozitë në shumën 6.200 euro, pranë “First Investment Bank”, me burim krijimi kursimet e realizuara ndër vite prej saj, të mbajtura në banesë, të deklaruara në deklaratimet e mëparshme
45. Duke qenë se shumatat e mësipërme janë deklaruar nga personi i lidhur gjendje në vitin 2016, janë analizuar në një kapitull. Komisioni, për të analizuar burimet e ligjshme të pasurive të deklaruara nga personi i lidhur/bashkëshortja, ka analizuar të gjitha deklaratimet e saj në vite. Referuar këtyre deklaratave ka rezultuar se në vitin 2010, vit në të cilin bashkëshortja e subjektit (për shkak të detyrës si avokate shteti) është bërë subjekt deklarues, ka filluar gjithashtu të bashkëjetojë me subjektin e rivlerësimit.
46. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2010, bashkëshortja e subjektit, znj. D. Sh, ka deklaruar si kursime *cash* të krijuara përpara bashkëjetesës me të ardhurat nga paga dhe dhurime të familjes dhe nga të afërmit të saj, shumën 15.000 euro.
47. Në vijim të deklaratimeve deri në vitin 2016, ajo e ka shtuar gjendjen *cash* vit pas viti edhe me vlerën 6.200 euro, derisa e ka përdorur si burim në vitin 2016 dhe në deklaratën *Vetting* për:
 - a. 5.000 euro dhënë subjektit për shlyerje huaje për apartamentin shtetasit H.H;
 - b. 6.200 euro hapje depozite bankare në “Fibank Albania”;
 - c. 10.800 euro gjendje *cash* në deklaratën *Vetting*.
48. Duke qenë se bashkëshortja e subjektit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 10.800 euro dhe depozitë bankare që rrjedh nga deklaratimet *cash* në vite, Komisioni fillimisht hetoi dhe kreu analizë për mundësinë e krijimit të shumës fillestare 15.000 euro, të deklaruar në vitin 2010 në deklaratën përpara fillimit të detyrës.
49. Komisioni i ka kërkuar subjektin të saktësojë për shumën 15.000 euro, gjendje *cash* se: sa janë kursimet e znj. D.Sh; sa është kontributi i prindërve të saj, duke specifikuar shumatat e dhëna për çdo vit; si dhe sa ka qenë kontributi nga të afërmit, duke saktësuar se cilët janë të afërmit dhe vitin kur janë dhënë këto shuma.

⁴³Referojuni vendimit nr. 10/2022 (JR), datë 14.4.2022, për subjektin e rivlerësimit F. I., etj.

50. Subjekti ka shpjeguar⁴⁴ se: “*Bashkëshortja D.Sh deri në ditën e fillimit të bashkëjetesës, datë 16.9.2009, ka jetuar me prindërit dhe vëllain. Marrëdhënia e saj ka qenë marrëdhënia prind-fëmijë, ku prindërit kanë përballuar sigurimin e të ardhurave të nevojshme për jetesën e familjes. Në këto kushte, shpenzimet e saj jetike janë mbuluar prej prindërve, ndërsa të ardhurat e saj nga puna janë kursyer për llogari të saj.*

Të ardhura e kursyera nga puna janë si vijon:

- a. *Në periudhën tetor 2005 – shtator 2007 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është paguar shuma 475.550 lekë;*
 - b. *Në periudhën 13 shtator 2007 – 31 dhjetor 2007 nga Agjencia Kombëtare e Turizmit është paguar shuma 121.115 lekë;*
 - c. *Në periudhën 9.1.2008 – 28.2.2009 nga Ministria e Kulturës është paguar shuma 699.745 lekë;*
 - d. *Në periudhën 1.3.2009 – 14.1.2010 nga Komisionieri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është paguar shuma 571.490 lekë;*
 - e. *Periudha⁴⁵ e punës së kryer nga ajo në Ministrinë së Brendshme nga data 19.12.2007 - 11.1.2008, ku është paguar në shumën 36.554 lekë.*
 - f. *Në përgjigje të pyetësorit për shpenzimet e udhëtimit, të dërguar në datën 4.5.2022, bashkëshortja⁴⁶ për periudhën 12 – 14.12.2007 ka qenë në një vizitë studimore në Mal të Zi, si punonjëse e A.K të T. Për këtë udhëtim pune ajo është paguar nga OSBE-ja në shumën 406 euro, ku në Shqipëri ka sjellë të pa harxhuar shumën 300 euro”.*
51. Subjekti, në vijim, ka shpjeguar se: “*Për sa i përket deklarimit të saj për ‘shuma të dhuruara herë pas here nga prindërit dhe të afërmit’, bashkëshortja më sqaron se kjo konsistente në dhurime të shumave që i janë bërë me rastin e përvjetorëve të ditëlindjeve të saj, diplomimit dhe festave të tjera. Sipas shpjegimeve të saj nuk mund të përcaktoj dot sot se cili nga të afërmit ia ka dhuruar dhe sa kanë qenë shuma e tyre. Në momentin e deklarimit shuma ka konsistuar në vlerën e sipërcituar dhe të deklaruar”.*
52. Në lidhje me burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume, subjekti ka depozituar dokumentacion⁴⁷ mbështetës, të cilat janë analizuar nga Komisioni.

Hetimi i Komisionit lidhur me kursimet *cash* të bashkëshortes

53. Komisioni ka hetuar në lidhje me burimet e ligjshme të shtetas D.Sh dhe të prindërve të saj.

⁴⁴ Në përgjigjet e pyetësorit 3, i dt 18.11.2022, ardhur me shkresën nr/***/ prot., datë 24.11.2022 dhe me shkresën ***/ prot., datë 2.12.2022

⁴⁵ Dokument depozituar nga subjekti me *email*-in e datës 30.11.2022, në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

⁴⁶ Pretendim i parashtruar nga subjekti *email*-in e datës 30.11.2022, në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

⁴⁷ Aktet e depozituara nga subjekti: vërtetimi nr. ***/ prot., datë 12.5.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pasqyrat financiare të pagës; vërtetimi nr. ***/ prot., datë 16.9.2022, i Agjencisë Kombëtare të Turizmit; vërtetimi nr. ***/ prot., datë 19.9.2022, i Ministrisë së Kulturës, bashkëlidhur borderotë e pagesave; vërtetimi nr. ***/ prot., datë 22.9.2022, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale; vërtetimi nr. D-*/ prot., datë 24.11.2022, i Ministrisë së Brendshme, të cilin do ta depozitojë me cilësinë e provës; *S of E* të OSBE-së, datë 24.11.2022; vërtetim për pagën e vlerësueshme L.L; vërtetim sigurimi P.L, nr. D-*/, datë 24.11.2022; *S of E* të OSBE-së, datë 24.11.2022.

54. ISSH-ja⁴⁸ ka referuar të dhëna për të ardhura të përfituara nga punësimi i rregullt i shtetases D.Sh nga janari 2012 e në vijim.
55. QKB-ja⁴⁹ nuk ka depozituar të dhëna për personin fizik “L.A.L”. Në faqen e QKB-së rezulton se personi fizik me këto të dhëna dhe me NUIS K***J nuk ka përditësuar të dhënat në QKB.
56. DPT-ja⁵⁰ ka informuar se:
- Shtetasi P.T.L nuk rezulton të ketë apo të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij.
 - Shtetasja L.A.L rezulton të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të saj (tregti me pakicë) si person fizik me NUIS K***J dhe që nga data 31.5.2012 rezulton me status “pasiv”. Deklaratat e viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009 janë dorëzuar me 0 (zero) xhiro, pra rezulton pa aktivitet.
57. ISSH-ja⁵¹ ka referuar të dhëna për të ardhura të përfituara nga:
- shtetasi P.L, nga punësimi i tij me të ardhura për periudhën janar 2012 – mars 2016. Në mars 2016 ka filluar të përfitojë pension pleqërie në shumën 23.584 lekë;
 - shtetasja L.L, nga punësimi i rregullt me të ardhura nga periudha shkurt 2012 – tetor 2015 dhe nga qershori 2019 e në vijim ka përfituar pension pleqërie në shumën 18.427 lekë.
58. “First Investment Bank”⁵² konfirmon se shtetasja D. P dispononte llogari kursimi me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 6.200 euro, e çelur më 26.10.2016.

Analiza financiare për kursimet *cash* 15.000 euro të bashkëshortes, në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2010

59. Në kushtet kur nuk është i qartë dhe i provuar dhurimi nga të afërm të bashkëshortes në vite, Komisioni, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në dosje, kreu një analizë mbi mundësinë e krijimit të shumës *cash* 15.000 euro nga bashkëshortja e subjektit dhe familjarë të saj, deri në fund të vitit 2009.
60. Nga analiza e kryer nga Komisioni rezultoi se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur mundësi për të krijuar shumën *cash* të deklaruar, pasi ka rezultuar me një balancë negative në shumën 1.278.177 lekë.
- Mundësia e krijimit të kursimeve *cash* për periudhën 2010 – 2016**
61. Analiza financiare për periudhën 2010 – 2016 është kryer duke përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe bashkëshortes, duke qenë se bashkëshortja deklarohet të ketë nisur në fund të vitit 2009.
62. Referuar deklarimeve në vite, bashkëshortja ka shtuar gjendjen *cash* në shumën 6.200 euro për periudhën 2010 – 2016. Referuar tabelës së përgjithshme financiare duket se

⁴⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022.

⁴⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2021.

⁵⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 21.4.2021.

⁵¹Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2022.

⁵²Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

ajo dhe subjekti kanë pasur mundësi të krijojnë shumat *cash* në vite, pasi kanë rezultuar me balanca pozitive.

63. Konstatime të Komisioni, nga hetimi rezultoi se:

63.1 Përputhet deklarimi me dokumentacionin e depozituar nga “Fibank Albania”.

63.2 Bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur mundësi financiare të ligjshme për të krijuar kursimet *cash* 10.800 euro, depozitën bankare në shumën 6.200 euro, si dhe dhënien e shumës 5.000 euro bashkëshortit në vitin 2016, pasi analiza ka rezultuar në vitin 2010 me një balancë negative në shumën 1.278.177 lekë.

63.3 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

64. Në lidhje me pamundësinë për të krijuar kursimet *cash*, të deklaruara nga bashkëshortja për vitin 2010, subjekti në prapësime ka shpjeguar se:

64.1 Mungesa e burimeve të ligjshme të bashkëshortes për krijimin e kursimeve në shumën 15.000 euro, deklaruar në DPV-në e parë të saj në vitin 2010, deklaruar para bashkëjetesës, nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur nga Komisioni dhe Kolegji.

64.2 Subjekti ka pretenduar se të ardhurat e bashkëshortes për këtë periudhë, të cilat janë përfshirë në analizë nga Komisioni kanë një lapsus, pasi kanë qenë në shumën 1.904.454 lekë, dhe jo sa i ka llogaritur Komisioni në shumën 1.596.423 lekë. Kjo shumë është kërkuar të rregullohet në analizën financiare të subjektit.

64.3 Në analizën financiare të kryer të llogariten të ardhurat e bashkëshortes së subjektit dhe prindërve të saj për periudhën 2005 – 2009, sipas provave të depozituara nga subjekti gjatë hetimit dhe pas prapësimeve. Për një përlllogaritje të saktë të këtyre të ardhurave duhet që nga Komisioni të llogariten të ardhurat për vjehrrin P.L për periudhën 1993 – 2009 dhe të përfshihen në analizë.

64.4 Subjekti ka pretenduar se duke qenë se deri në vitin 2007 të ardhurat e familjes së bashkëshortes, duke përfshirë edhe të ardhurat e saj, ku u trajtua dhurata e dhënë nga prindërit në shumën 3.000 euro, kanë rezultuar me gjendje pozitive, kjo e ardhur duhet të mbartet dhe të llogaritet si gjendje *cash* progresive në vitet 2008 dhe 2009. Subjekti shpjegon se, nëse merren në konsideratë këto pretendime, do të vërtetohet se bashkëshortja ka pasur mundësi për të kursyer shumën 15.000 euro, të përcaktuar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2010.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me kursimet *cash* të bashkëshortes

65. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, si dhe bazuar në aktet provuese të depozituara prej tij pas prapësimeve, Komisioni i gjeti të drejta pretendimet e subjektit dhe përfshiu

në analizën financiare të ardhurat e ligjshme të dokumentuara të bashkëshortes së subjektit, znj. D.Sh, si dhe të prindërve të saj deri në vitin 2009.

65.1 Mbështetur në sa më sipër, analiza financiare për kursimet dhe depozitën e bashkëjetueses, të analizuara pas prapësimeve, ka rezultuar me një balancë pozitive.

Situata financiare pas prapësimeve për periudhën 1994 – 2016

66. Analiza financiare e subjektit për periudhën 1994 – 2016 ka rezultuar me një balancë negative në vitin 2009 në shumën 354.586 lekë, sipas tabelës vijuese.

PERSHKRIMI	PASURI	DETYRIME	PASURINETO	TEARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI
1994-2003	1 350 000	-	1 350 000	4 063 166	2 488 822	224 344
2004	300 000	-	300 000	762 071	153 964	308 107
2005	350 000	-	350 000	763 602	178 748	234 855
2006	185 230	-	185 230	837 467	169 557	482 680
2007	861 542	-	861 542	1 257 963	350 833	45 588
2008	5 277 499	4 800 000	477 499	946 293	157 561	311 233
2009	956 196	-	956 196	925 606	323 996	- 354 586
2010	2 427 482	-	2 427 482	3 669 558	784 349	457 727
2011	462 401	-	462 401	1 873 662	1 095 927	315 334
2012	- 166 706	-	- 166 706	1 509 839	857 305	819 240
2013	240 140	-	240 140	2 158 401	1 582 521	335 740
2014	- 540 928	-	- 540 928	1 896 091	2 413 454	23 565
2015	4 660	-	4 660	1 980 270	1 973 335	2 276
2016	- 613 565	-	- 613 565	2 061 089	2 198 684	475 970

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

67. Nga vlerësimi në tërësi i pasurive të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se nga deklaratimet në deklaratën *Vetting* nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklaram të rremë. Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pasaktësi në deklaramin e subjektit lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për investimet në pasurinë e subjektit dhe bashkëshortes, në raport edhe me deklaramin e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, çmohet se proporcionalisht këto konstatime, si një shkak i vetëm dhe i veçuar, nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

68. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të

parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar raportin⁵³ në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Altin Shkurti në detyrën e gjyqtarit.

Vlerësimi i Komisionit nga kontrolli i figurës

69. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja në vitin 2017 dhe nga informacioni i ardhur ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna shtesë.

Komisioni si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

70. Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, hetimi i Komisionit është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor⁵⁴ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

71. Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është hartuar nga KLGJ-ja, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit;
- tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhëna nga burimet arkivore, si dhe
- pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

⁵³Në shkresën nr. *** prot. është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. ***, datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

⁵⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2022.

72. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Altin Shkurti përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezultoi që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

73. Sa i takon gjetjeve mbi dokumentet e paraqitura nga subjekti:

- a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.

- b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë në degën Drejtësi dhe ka marrë titullin “Jurist” pranë Universitetit të Tiranës në datën 11.7.1995, ndërsa Shkollën e Magjistraturës e ka përfunduar në vitin 2000.

Më pas, me Dekretin Nr. ***, datë 27.9.2000, të Presidentit të Republikës, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vijon të ushtrojë funksionin aktualisht.

- c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka deklaruar se 3 vitet e fundit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kryer çdo proces që lidhet me këtë veprimtari deri në dhënien e vendimit, duke përcaktuar fushën e të drejtës civile.

Lidhur me të dhënat statistikore, subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka deklaruar se gjatë 3 viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1803 çështje, ka përfunduar gjithsej 1508 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 124 çështje të vitit 2016.

PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

74. Nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar nga Komisioni të japë shpjegime për çështjen vijuese.

74.1 Çështja civile nr. *** regj., datë 26.2.2016, që i përket paditësit zyra avokatore “H & H”, kundër të paditurit V.N, me objekt “detyrimi për pagimin e çmimit të shërbimit që rrjedh nga kontrata e shërbimeve profesionale, marrjen e masës së sigurimit të padisë...”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.6.2016.

74.2 Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.2.2016 dhe, sipas shënimit në dosje të kryetarit të Gjykatës, me shortin e datës 1.3.2016 i ka kaluar për gjykim gjyqtarit Altin Shkurti. Me vendimin e datës 3.3.2016, gjyqtari Altin Shkurti ka vendosur kalimin e çështjes në seancën përgatitore më 8.3.2016.

74.3 Në përfundim të gjykimit në seancën e datës 27.6.2016, evidentohet se është paraqitur përfaqësuesi me autorizim i palës paditëse, por nuk është paraqitur i padituri, për të cilin ishte kryer njoftimi me shpallje. Pasi gjykata ka vendosur të vazhdojë gjykimin në mungesë të të paditurit, pala paditëse ka paraqitur aktin provë shkresore të kërkuar nga gjykata. Gjukata ka lejuar marrjen dhe shqyrtimin e provave shkresore të paraqitura, duke i administruar ato. Me kërkesën e palës paditëse, gjykata i ka dhënë fund hetimit gjyqësor dhe ka ftuar palën paditëse për pretendimet përfundimtare. Pasi pala paditëse ka relatuar dhe depozituar pretendimet e tyre përfundimtare me shkrim, gjykata ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur V. N për të përmbushur detyrimin kontraktor të përcaktuar në kontratën ‘Për shërbime profesionale juridike’, datë 24.1.2014, duke i paguar palës paditëse Zyra e Avokatisë ‘H& H’ shumën 228.000 lekë”.

74.4 Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i padituri, por dosja nga data 30.3.2018, kur është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë e deri në datën 29.9.2022, kur është bërë verifikimi, ndodhej ende në pritje të gjykimit në shkallën e dytë.

74.5 Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 26 ditë, në intervalin kohor 1.3.2016 - 27.6.2016. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit dhe është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Konstatime të Komisionit

75. Komisioni, për këtë rast, ka konstatuar se nuk është disponuar në dispozitiv lidhur me pikën e dytë të objektit të padisë, marrjen e masës për sigurimin e padisë, në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se *gjukata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet* dhe nenin 28 “Gjukata në procesin gjyqësor civil” të këtij Kodi që parashikon se *gjukata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi...*”.

75.1 Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, si dhe të depozitojë prova, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

76. Subjekti në prapësime ka shpjeguar se kjo çështje është gjykuar në bazë të Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve të ndodhura me ligjin nr. 37/2017 (hyrë në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, 98, datë 5.5.2017), ndryshime që përcaktuan edhe shqyrtimin e kërkesës për masë sigurimi në dhomë këshillimi.

76.1 Subjekti ka shpjeguar se sipas ligjit procedural të kohës, pas njohjes me kërkesëpadinë në datën 3.3.2016, ka caktuar seancën e parë përgatitore, brenda 5 ditëve, më 8.3.2016, ora 9:45. Tri nga seancat janë shtyrë për shkak të mosmarrjes së njoftimit të të paditurit.

76.2 Në seancë përgatitore pala paditëse ka kërkuar njoftimin me shpallje të të paditurit, pasi adresa e përcaktuar në kërkesëpadi, e nxjerrë nga sistemi elektronik i zyrës së Gjendjes Civile, është e saktë. Në këto kushte, gjykata ka shtyrë seancën gjyqësore në datën 26.4.2016 për të njoftuar të paditurin me shpallje publike.

76.3 Subjekti shpjegon se masat e sigurimit të padisë kanë karakter të ngutshëm, nisur nga fakti që kërkojnë sigurimin e zbatimit të vendimit gjyqësor që mund të bëhet i vështirë ose i pamundur për paditësin. Nisur nga karakteri i tyre i ngutshëm, gjykata ka caktuar seancën e parë përgatitore brenda 5 ditëve nga marrja e dosjes për shqyrtim.

76.4 Pavarësisht karakterit të tyre të ngutshëm, nga procesverbalet gjyqësore rezulton se në asnjërën prej 3 seancave përgatitore të zhvilluara pala paditëse nuk i ka kërkuar gjykatës të marrë në shqyrtim kërkimin për marrjen e masës së sigurimit, konform nenit 205/2 të Kodit të Procedurës Civile, që përcaktonte se *kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër* dhe gjykata mund të shprehej me vendim.

76.5 Po kështu, rezulton se në asnjërën prej 2 seancave gjyqësore të zhvilluara në datat 25.5.2016 dhe 27.6.2012, pala paditëse nuk ka kërkuar që gjykata të marrë në shqyrtim kërkimin për marrjen e masës së sigurimit dhe të shprehet për pranimin ose rrëzimin e saj.

76.6 Gjukata, pavarësisht përcaktimit të kërimit të padisë për marrjen e masës së sigurimit, në padi, referuar ligjit procedural të kohës, nuk mund të merrte kryesisht në shqyrtim kërkimin për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, pa u kërkuar shqyrtimi i saj në seancë nga paditësi. Kërkimi i vendosjes së masës së sigurimit ka qenë në diskrecionin e paditësit, i cili e kërkon në mënyrë të shprehur në seancën përgatitore/gjyqësore. Në rast të parashtrimit në seancë të kërimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë, paditësi duhej të vërtetonte përpara gjykatës plotësimin e kushteve ligjore të caktimit të saj, si dhe të provonte ekzistencën e rrezikut të mosekzekutimit ose vështirësisë së zbatimit të vendimit. Në vijim të seancës duhej që edhe pala e paditur të jepte kundërargumentet e saj, në përputhje me zbatimin e parimit të kontradiktorialitetit dhe vetëm pas këtij momenti procedural, gjykata shprehet me vendim për pranimin/rrëzimin e saj.

76.7 Në kushtet kur paditësi nuk ka kërkuar që gjykata të marrë në shqyrtim kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit, gjykata nuk mund ta merrte atë në shqyrtim kryesisht dhe të shprehej për pranimin/rrëzimin e saj, pasi një vendimmarrje e tillë do të cenonte të drejtat e palës tjetër në proces, e cila nuk kishte marrë njoftim, duke shkelur një ndër parimet themelore të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, kontradiktorialitetin. Me moskërkimin për marrjen në shqyrtim të masës së sigurimit, paditësi ka hequr dorë nga ky kërkim në mënyrë të heshtur.

76.8 Në kushtet e mosvendosjes së masës së sigurisë gjatë gjykimit të çështjes për shkak të moskërkimit nga pala paditëse dhe moskërkimit as në kërkimet përfundimtare, gjykata nuk është shprehur në përfundim të gjykimit për vendosjen e masës së sigurimit ose ligjërimin e saj në rast të vendosjes gjatë gjykimit, konform përcaktimit të neneve 211/2 dhe 212/1 të Kodit të Procedurës Civile.

76.9 Duke pasur parasysh këtë fakt, subjekti ka shpjeguar se nuk ka disponuar në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se *gjkata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet dhe nenin 28 “Gjkata në procesin gjyqësor civil” të këtij Kodi, që parashikon se gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi... Gjkata është shprehur në dispozitivin e vendimit për të gjithë kërkimin e paditësit duke vendosur: “Detyrimin e palës së paditur V.N për të përmbushur detyrimin kontraktor të përcaktuar në kontratën ‘Për shërbime profesionale juridike’, datë 24.01.2014, duke i paguar palës paditëse, zyra e avokatisë ‘H & H’, shumën 228.000 lekë. Lëshimin e urdhërezekutimit për zbatimin e këtij vendimi sipas dispozitivit të tij, pasi vendimi të marrë formë të prerë në një kopje të veçantë”.*

Vlerësimi i Komisionit

77. Në prapësime subjekti ka depozituar akte nga dosja gjyqësore që i përket vendimit me nr. ***, datë 27.6.2016. Nga procesverbalet e seancës përgatitore dhe të seancave gjyqësore rezulton se pala paditëse nuk ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit të padisë. Për pasojë, shpjegimet e subjektit në prapësime janë të mbështetura në dokumentacion provues dhe përputhen me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

ANALIZA E GJETJEVE

78. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

78.1 Nga verifikimi i dosjeve të vëzhguara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor, ndonëse në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor në raste të rralla. Gjithashtu, konstatohet se ai nuk përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

78.2 Ai ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes dhe është i aftë të identifikojë rastet, kur zbatohet ligji specifik apo ligji i kohës.

78.3 Në të gjitha çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale u kushton rëndësi rrethanave që përligjin ose jo arrestimin e personave nën hetim dhe nëse masa e sigurimit e kërkuar nga organi i prokurorisë u përshtatet ose jo kërkesave dhe kritereve ligjore të parashikuara nga ligji.

b) Arsyetimi ligjor

78.4 Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

79. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

79.1 Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Altin Shkurti ka përfunduar gjithsej 1531 çështje gjyqësore.

79.2 Sipas pikës 3, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile me palë kundërshtare brenda një viti kalendarik. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 360 gjykime çështjesh civile për 3 vjet. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e subjektit të rivlerësimit Altin Shkurti konstatohet se ngarkesa e tij sasiore me 651 çështje në 3 vjet ka qenë mbi standardin minimal.

79.3 Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Altin Shkurti ka qenë gjithmonë brenda afateve standarde apo ligjore.

79.4 Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Altin Shkurti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, për të mos pasur vonesa dhe brenda afateve ligjore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

79.5 Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në çështjet civile të vëzhguara, ai ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

79.6 Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se në përgjithësi ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile dhe procedurale penale.

80. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

80.1 Sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Altin Shkurti.

b) Integriteti

80.2 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

80.3 Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Altin Shkurti. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

81. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

81.1 Në aktet e vëzhguara është konstatuar se gjyqtari Altin Shkurti komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

81.2 Në aktet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Altin Shkurti për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 7 nga 8 rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

81.3 Subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 7 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 11 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile.

DENONCIME

82. Pranë Komisionit u depozituan 15 denoncime nga publiku. Pas analizimit të tyre subjektit iu kërkuan shpjegime për dy denoncime.

82.1 Denoncim i shtetasit N. M

82.1.1 Denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka shkaktuar vonesa në hapat proceduralë të ndjekur, të cilët sipas denoncuesit janë bërë për të zvarritur ekzekutimin e detyrimit dhe për të përfituar pala tjetër debitore. Denoncuesi pretendon se gjatë arsyetimit të vendimit dhe në dispozitiv gjyqtari Altin Shkurti ka bërë gabime materiale dhe denoncuesi ka bërë kërkesë për ndreqje gabimi. Në vijim, denoncuesi pretendon se në seancën gjyqësore për ndreqjen e gabimit ka qenë i pranishëm personi i tretë, pala tjetër ndërgjyqëse, por gjyqtari Altin Shkurti ka shkruar në vendim se ishte në mungesë. Denoncuesi pretendon se ky fakt provohet në procesverbalet e seancës, ku është

pasqyruar prezencën e personit të tretë. Denoncuesi pretendon se palës së tretë i lihej e drejta e ankimit nga data e komunikimit të vendimit.

82.1.2 Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe të depozitohet prova, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

82.1.3 Subjekti ka shpjeguar se pretendimi i denoncuesit lidhur me një gabim material të bërë për të favorizuar palën e paditur është i pabazuar për arsyet vijuese:

82.1.4 Subjekti ka shpjeguar se me vendimin nr. ***, datë 25.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur pranimi i padisë së paditësit N.M (pra, janë pranuar kërkesat e denoncuesit). Në kushtet kur çështja është zgjidhur drejt në favor të denoncuesit, subjekti argumenton se nuk mund të pretendohet që është bërë për të favorizuar palën tjetër. Palët ndërgjyqëse janë të përcaktuara qartë që në pjesën hyrëse të vendimit gjyqësor, kështu që kuptohet që është një gabim material i bërë nga gjykata në dispozitivin e saj, duke shkruar gabimisht gjeneralitetet e paditësit të kundërpaditur nga N.M në F.S.

82.1.5 Në vijim, subjekti ka argumentuar se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 2.6.2009 dhe po kështu, Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 12.10.2011, ka vendosur “mospranim rekursi”.

82.1.6 Subjekti ka shpjeguar se në volumin e vendimeve që arsyetohen prej tij, referuar këtu dhe statistikave vjetore, kryerja e gabimeve materiale është e pashmangshme, ndaj dhe ligjvënësi në nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar institutin e ndreqjes së gabimeve materiale.

82.1.7 Subjekti argumentoi se vetë palët ndërgjyqëse, kur konstatojnë gabime materiale, mund t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë për ndreqjen e tyre. Rezulton se denoncuesi i është drejtuar gjykatës për korrigjimin e gabimit material në vitin 2012, ndërkohë që çështja është zgjidhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 25.10.2007. Pra, denoncuesi është vënë në dijeni të vendimit të arsyetuar dhe gabimit material të tij që në vitin 2007 dhe ai për 5 vjet nuk i është drejtuar gjykatës për ndreqjen e këtij gabimi material. Për rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i tij se ky gabim material e ka penguar për të ekzekutuar vendimin e gjykatës.

Vlerësimi i Komisionit

82.1.8 Sikurse u shpjegua nga subjekti, ngarkesa e punës dhe numri i lartë i çështjeve në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë shkaqe të arsyeshme për kryerjen e ndonjë gabimi material në vendim. Për më tepër, ndreqja e gabimeve është e parashikuar në nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile, si një mekanizëm për të zgjidhur këtë lloj problematike.

82.1.9 Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim dhe nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës në lidhje me pretendimin se në seancën gjyqësore për ndreqje gabimi, me kërkesë të palës paditëse, ka qenë e pranishme edhe pala tjetër ndërgjyqëse, ndërsa në vendim është shkruar se ishte në mungesë.

82.1.10 Trupi gjykues vëren se nga ana e gjyqtarit nuk është treguar kujdesi i duhur e, për pasojë, kjo sjellje ka shkaktuar vonesë në ekzekutimin e vendimit. Lidhur me kriterin profesional, kjo mangësi mbetet e pashoqëruar me mangësi të tjera dhe nuk është e mjaftueshme për ta vlerësuar subjektin e rivlerësimit me cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët apo se ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

82.2 Denoncim i shtetasit B.K

82.2.1 Denoncuesi ka ngritur pretendime për gjyqtarin Altin Shkurti për mosrespektim të procedurës gjyqësore dhe njëanshmëri në gjykimin e çështjes. Çështja e tij është regjistruar në gjykatë në vitin 2015 dhe në datën e depozitimit të ankesës pranë Komisionit, datë 4.4.2019, kjo çështje ende nuk kishte përfunduar. Denoncuesi, gjithashtu, ka ngritur pretendime që gjykata i ka lënë detyra ekspertit, jo ato të kërkuara nga palët, duke treguar kështu njëanshmëri në proces. Sipas denoncuesit, çështja e tij duhet të gjykohej nga një trup gjykues i përbërë nga 3 gjyqtarë, pasi çështja në gjykim e kalon vlerën prej 50 milionë lekësh, sipas parashikimeve të nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile.

82.2.2 Në lidhje me këto pretendime, subjektit iu kërkuar shpjegime dhe të depozitojë prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

82.2.3 Në prapësime subjekti ka shpjeguar se nuk është i vërtetë fakti që çështja ka qenë e papërfunduar në datën e depozitimit të ankesës pranë Komisionit, sepse kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe aktualisht gjendet për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

82.2.4 Subjekti pretendon se është i pambështetur edhe pretendimi tjetër i denoncuesit që gjykata nuk i ka caktuar ekspertit detyrat e lëna nga palët, por i ka caktuar vetë ato, fakt që tregon njëanshmëri.

82.2.5 Subjekti shpjegon se gjykata, në bazë të nenit 227/1 të Kodit të Procedurës Civile, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij, me vendim, pasi ka marrë më parë mendimin e palëve: *“Në punën time si gjyqtar përpiqem që t’u jap zgjidhje të gjitha kërtimeve të palëve, që kanë lidhje me objektin e shqyrtimit të çështjes. Detyrat që nuk kanë lidhje me objektin e çështjes janë të papranueshme dhe, për rrjedhojë, nuk pranohen me vendim të arsyetuar. Ndaj këtij vendimi pala ka të drejtë të ushtrojë ankim së bashku me vendimin përfundimtar”*.

82.2.6 Subjekti ka shpjeguar se detyrat fillimisht i janë caktuar ekspertit në seancën gjyqësore të datës 2.6.2017. Pala paditëse ka paraqitur pyetje, ndërsa pala e paditur nuk ka pasur.

82.2.7 Pasi palët janë njohur me aktekspertimin, në seancën gjyqësore të datës 18.9.2017, pala e paditur ka paraqitur pyetje për ekspertin. Eksperti u është përgjigjur pyetjeve të palës së paditur në seancë gjyqësore dhe përgjigjet e tij janë pasqyruar në procesverbalin e seancës gjyqësore. Pasi është njohur me përgjigjet, pala e paditur ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për të rishikuar edhe një herë aktekspertimin, pasi

u njoh edhe me sqarimet që i dha eksperti në këtë seancë gjyqësore, për të parë nëse ka pyetje të tjera ose jo. Kjo kërkesë e palës së paditur është pranuar nga gjykata dhe seanca gjyqësore është shtyrë në datën 3.10.2017.

82.2.8 Seanca gjyqësore e datës 23.1.2018 është shtyrë më 29.1.2018, për të njoftuar ekspertin, në bazë të kërkesës së av. N.K dhe E.S, të paditurit A.K, për të bërë pozicionimin e pronës, duke iu referuar tre kufitarëve të tjerë.

82.2.9 Në seancën gjyqësore të datës 29.1.2018, gjykata, në bazë të kërkesës së av. N. K, të bashkëpaditurit A.K i ka caktuar me vendim ekspertit detyra shtesë. Kjo seancë është shtyrë me kërkesë të ekspertit për të përgatitur përgjigjet e pyetjeve shtesë.

82.2.10 Pyetjeve të avokatit të bashkëpaditurit A.K, eksperti u ka dhënë përgjigje në seancën gjyqësore të datës 12.2.2018. Kjo seancë është shtyrë më 27.2.2018 për t'u njohur palët me shtesën e aktekspertimit.

82.2.11 Nga sa më sipër, rezulton se gjykata ka pranuar pyetjet e palës së paditur për ekspertin, i ka përfshirë ato në detyrat e dhëna ekspertit, duke zhvilluar në këtë mënyrë një proces të rregullt kontradiktor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

82.2.12 Ky fakt rezulton i provuar edhe me arsyetimin e këtij vendimi, ku gjykata lidhur me këtë pretendim të pretenduesit është shprehur sa vijon: *“Gjykata për të vërtetuar pretendimet e paditësve urdhëroi edhe kryerjen e një akti ekspertimi nga eksperti topogaf. Në aktekspertimin e datës 24.7.2017 dhe shtesat e tij, eksperti pozicionoi pronat e palëve ndërgjyqëse. Në aktekspertim eksperti pozicionoi pronën e palës paditëse, sipas notës së transkriptimit dhe pronën e palës së paditur sipas kartelës së pasurisë të ZVRPP-së Tiranë nr. ***, ku rezultoi një mbivendosje me sipërfaqe 2647 m² dhe sipas vendimit të AKKP-së nr. ***, datë 27.11.1996 e në vijim, ku rezultoi një mbivendosje me sip. 2323 m²...”*.

82.2.13 Në lidhje me pretendimin se çështja nuk është shqyrtuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, por me një gjyqtar, në shkelje të procedurës është i pabazuar. Referuar ligjit procedural të zbatueshëm në kohën kur është regjistruar për shqyrtim çështja datë 15.12.2015, referuar nenit 35/2 të Kodit të Procedurës Civile, është përcaktuar se: *“Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen këto çështje: a) paditë me vlerë më shumë se 20 milionë lekë vetëm nëse një nga palët e kërkon në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij Kodi”*. Në kushtet kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar në seancën përgatitore të datës 14.4.2016 zhvillimin e gjykimit me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, gjykata ka vazhduar gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, pretendime këto të pasqyruara në procesverbalin e seancës përgatitore, datë 14.4.2016.

Vlerësimi i Komisionit

82.2.14 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar dhe ka depozituar aktet e dosjes gjyqësore të vendimit me nr. ***, datë 27.7.2018, me palë të paditur B.K etj. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore nuk rezultuan të provuara pretendimet e denoncuesit.

82.2.15 Përfundimisht, u konstatua se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

83. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁵⁵ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁵⁶, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.
84. Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer rivlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.
 - Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
 - Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
 - Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

85. Bazuar në germën “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur një nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me germën “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

⁵⁵Shihni opinionin me nr. 824/2015 të Venecias.

⁵⁶Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Altin Shkurti ka plotësuar së bashku kushtet vijuese:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Altin Shkurti, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 3.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha